
BULETIN INFORMATIV

QERSHOR 2026

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të
Akademisë së Shkencave të
Shqipërisë**

Qershor, 2026

Përmbajtje

Aktivitet	6
Vizita zyrtare e delegacionit të ASHSH-së në Kosovë: Takime institucionale në Prishtinë për forcimin e bashkëpunimit akademik e kulturor	7
Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit	9
Vizitë zyrtare dyditore e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në Azerbajxhan	11
U mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare “Kur toka flet me emra” – Hapësira si kujtesë.....	14
Fjala e Kryetarit të ASHSH-së, akad. Skënder Gjinushi, në konferencën shkencore ndërkombëtare: “Kur toka flet me emra – Hapësira si kujtesë”	20
Akademia e Shkencave mbështet kërkesat e shqetësimit e drejta të shqiptarëve të Preshevës dhe është e gatshme të bashkëpunojë për adresimin e tyre	23
Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi takoi dr. Bruno Kragić, drejtorin e Rrjetit European të Enciklopedive	25
U mbajtën punimet e konferencës së parë shkencore ndërkombëtare kushtuar enciklopedizmit shqiptar	27
Mbylli punimet konferenca e parë shkencore ndërkombëtare kushtuar enciklopedizmit shqiptar	32
Nisi punimet konferenca e 4-t ndërkombëtare për shëndetin publik dhe mjedisin	34
Mbylli punimet konferenca e 4-t ndërkombëtare për shëndetin publik dhe mjedisin.	38
U zhvillua konferenca shkencore ndërkombëtare me temën “Aspekte ekonomike gjatë mesjetës dhe periudhës osmane në trojet shqiptare”	41
U mbajt forumi me temë “Cashless Albania 2030 – Një ekonomi pa përdorimin e parasë fizike: a jemi gati?”	44

Forcohet bashkëpunimi shkencor Shqipëri-Kosovë në Gjeoshkenca, hartohet agenda e përbashkët kërkimore 2027–2030	47
Nisi punimet konferenca shkencore me temën “Përjetësimi i heronjve dhe dëshmorëve kombëtarë për çështjen e Kosovës (1980–1999)” në Prishtinë.....	50
"U zhvillua workshop-i i 5-të me temën “Nanotech Science Meets Industry: Research, Innovation and Collaboration”"	52
Nis sezoni kërkimor sezoni i gërmimeve arkeologjike për vitin 2026 në bazilikën paleokristiane.....	55
Akademik Gëzim Hoxha, përfaqëson Akademinë e Shkencave të Shqipërisë në samitin e organizuar me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Parë të Turkologjisë në Azerbajxhan	56
Akademia e Shkencave e Shqipërisë, nderohet me medalje në samitin ndërkombëtar kushtuar 100-vjetorit të Kongresit të Parë të Turkologjisë	58
Institutet dhe komisionet	60
U zhvillua workshopi “Si zë fill gjuha? Matje në nivel kombëtar e zhvillimit gjuhësor të foshnjave"	61
U mbajt ligjërata “Skena dhe sisteme të ndryshme teatrale – Një analizë krahasuese”, me referuese znj. Abigeila Voshtina	63
Në mjediset e Muzeut Arkeologjik u zhvillua koncert-konferenca “Nga lira e lashtësisë drejt teatrit lirik” me studiuesin e Akademinë Ndërkombëtare të Lirës dr. Nikos Xanthoulis	65
Vizitë zyrtare në Muzeun Arkeologjik të Akademisë së Shkencave: Shqipëria dhe Lituania forcojnë bashkëpunimin	67
U zhvillua seminari me temën “Sjellja ndaj zjarrit e fasadave të ventiluara: analiza termofluidike e efektit oxhak dhe roli i barrierave”	69
U mbajt ligjërata me temën: "Aplikime të fonetikës akustike në studimet dialektologjike" nga prof. Luciano Romito.....	72
U zhvillua mbledhja e Komisionit të Përhershëm të Shkencave Mjekësore.....	74
Workshop për përforcimin e bashkëpunimit shkencor dhe funksionalizimin e grupeve të punës të Njesisë "Pasuritë Ujore"	76
Botime të reja	77
Botimet më të reja të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë	78

Promovohet libri i prof. asoc. dr. Ethem Çekut: “Lëvizja shqiptare për pavarësi: Politika, kryengritjet dhe diplomacia, 1908–1912”	79
“Paradigma në grupe emërore” nga akad. Ethem Lika	82
Botohet nga Akademia e Shkencave “Pjetër Budi, Vepra III: Rituali roman (1621)”, përgatitur nga prof. Bardhyl Demiraj	83
Botimi i ri shkencor i akad. Albert Doja në fushën e antropologjisë së fesë	84
U prezantua libri “Don Gjon Buzuku dhe ‘Meshari’ i tij” i autorit Bardhyl Demiraj ..	86
Podcast Akademia	89
Podcast AKADEMIA 1: Intervistë me akademik Arben Merkoçin	90
Podcast AKADEMIA 2: Intervistë me z. Andreas Dushi, drejtor i QBAE.....	91
Të tjera	92
Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron akademikët dhe studiuesit në ditët e lindjes.....	93
Certifikimi i “Mbledhësve të traditës”, mirënjohje për ruajtësit e kujtesës shqiptare .	94
Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare organizuan ligjëratën “Meshari i (pa)njohur” nga prof. dr. Vehbi Miftari	95
Forcimi i bashkëpunimit shkencor rajonal në hortikulturë: përvoja dhe perspektivat e Grupit të Punës të ISHS nën udhëheqjen e akad. Nazim Gruda	98
27 vjet nga hyrja e trupave të NATO-s në Kosovë	99
Dita Ndërkombëtare e Arkivave: Ruajtja e kujtesës dokumentare.....	100
Përkujtojmë themelimin e Institutit të Sportit “Vojo Kushi” në Tiranë	101
Dita Botërore e Muzikës: Një festë globale e harmonisë dhe dialogut kulturor	103
In memoriam	104
Akademia e Shkencave e Shqipërisë përkujton personalitete të shquara të shkencës dhe kulturës në muajin qershor	105
Ndahet nga jeta inxhinieri Ismail Ahmeti, një personalitet i shquar i historisë së energjetikës dhe ndërtimit shqiptar.....	106

Aktivitet

Vizita zyrtare e delegacionit të ASHSH-së në Kosovë: Takime institucionale në Prishtinë për forcimin e bashkëpunimit akademik e kulturor



Delegacioni i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH), i udhëhequr nga Kryetari, akad. Skënder Gjinushi, në kuadër të vizitës zyrtare në Kosovë, zhvilloi takime institucionale te Ministri i Arsimit dhe Shkencës, z. Hajrulla Çeku, si dhe te Ministria e Kulturës dhe Turizmit, znj. Saranda Bogujevci. Në përbërje të delegacionit ishin akad. Vasil Tole, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Anila Hoda, sekretare shkencore, si dhe akad. Anastas Angjeli.

Gjatë këtyre takimeve, delegacioni i ASHSH-së shoqërohej nga drejtuesit më të lartë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK), përkatësisht nga Kryetarja, akad. Justina Shiroka-Pula, nënkryetari, akad. Fejzullah Krasniqi, dhe sekretari shkencor, akad. Bardh Rugova.

Takimet u zhvilluan në një frymë të lartë bashkëpunimi institucional dhe akademik, ku fokus i veçantë iu kushtua rëndësisë së forcimit të lidhjeve ndërmjet institucioneve shkencore, arsimore dhe kulturore në të gjithë hapësirën shqiptare.

Gjatë bisedimeve të përbashkëta u ritheksua roli i pazëvendësueshëm që akademitë kanë në zhvillimin e mëtejshëm të dijes, kërkimit shkencor, arsimit të lartë, si dhe në mbrojtjen e kultivimin e kulturës dhe trashëgimisë kombëtare.



Këto vizita shërbyen gjithashtu si një mundësi e shkëlqyer për të shkëmbyer mendime konkrete mbi bashkëpunimet e ardhshme ndërinstytucionale, veçanërisht në fushën e shkencës, arsimit, kulturës, botimeve akademike dhe promovimit të vlerave të përbashkëta kombëtare.

Në mbyllje, takimet e realizuara u vlerësuan lart si një hap i rëndësishëm në koordinimin dhe forcimin e mëtejshëm të komunikimit ndërmjet institucioneve akademike dhe atyre qeveritare në Kosovë dhe Shqipëri.

Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit



Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e përfaqësuar nga delegacioni i kryesuar nga Kryetari i ASHSH-së akad. Skënder Gjinushi, i shoqëruar nga akad. Anastas Angjeli, Kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si dhe prof. asoc. dr. Elda Zotaj, përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun, zhvilloi një vizitë zyrtare dyditore në Azerbajxhan, ku në qendër të agjendës ishte forcimi i marrëdhënieve ndërinstitucionale. Momenti kryesor i kësaj vizite ishte nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për Bashkëpunim Shkencor ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit, i nënshkruar nga Kryetari i ASHSH-së, akad. Skënder Gjinushi, dhe akad. Isa Habibbeyli. Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë anëtarë të presidiumit dhe drejtorët e instituteve të Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit.

Ky dokument shënon një gur themeli në marrëdhëniet mes dy akademive dhe vendos kornizën për një bashkëpunim të gjerë shkencor, ku palët kanë shprehur vullnetin për të bashkëpunuar veçanërisht në disiplinat e Shkencave Sociale, Shkencave Humane, Sizmologjisë dhe Inteligjencës Artificiale.

Firmosja e këtij dokumenti hap rrugë për përpjekje të përbashkëta në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve kërkimore, aplikimin për projekte bilaterale dhe multilaterale, si dhe lehtësimin e shkëmbimit të personelit dhe ekspertëve.



Gjithashtu, memorandumi parasheh organizimin e përbashkët të konferencave, seminareve dhe simpoziumeve shkencore, si dhe shkëmbimin e informacionit shkencor dhe publikimeve akademike ndërmjet dy institucioneve.

Ky akt institucional konfirmon angazhimin e palëve për forcimin e mëtejshëm të lidhjeve shkencore në nivel ndërkombëtar, duke i dhënë një hov të ri bashkëpunimit mes dy institucioneve.

Vizitë zyrtare dyditore e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në Azerbajxhan



Në datat 22–23 qershor, delegacion i kryesuar nga Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, i shoqëruar nga akad. Anastas Angjeli, Kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si dhe prof. asoc. dr. Elda Zotaj, përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun, zhvilloi një vizitë zyrtare dyditore në Azerbajxhan.

Vizita u realizua me ftesë të Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit (AMEA) dhe kishte për qëllim vendosjen e marrëdhënieve ndërkademiçe si dhe nxitjen e bashkëpunimit shkencor dhe identifikimin e mundësive të reja për zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta kërkimore në fusha me interes të ndërsjellë.

Gjatë qëndrimit në Baku, delegacioni zhvilloi një program të gjerë takimesh me drejtues të Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit dhe të institucioneve të saj kërkimore, përfshirë Presidentin e AMEA -s akad. Isa Habibbeyli. Delegacioni u njoh nga afër me organizimin institucional, prioritetet strategjike dhe veprimtarinë shkencore të AMEA-s, si dhe me punën e instituteve në varësi të saj.

Programi i vizitës dyditore nisi në Institutin e Dorëshkrimeve “Muhammad Fuzuli”, ku

delegacioni u prit nga drejtori i institutit, Teymur Kerimli. Gjatë takimit u diskutuan çështje që lidhen me studimin, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë së shkruar, si dhe mundësitë e bashkëpunimit në fushën e shkencave humane dhe studimeve historike. Më pas u realizua një vizitë në godinën qendrore të Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit dhe në Institutin e Letërsisë “Nizami Ganjavi”, ku delegacioni u njoh me veprimtarinë kërkimore të institutit dhe zhvilloi diskutime mbi perspektivat e bashkëpunimit në fushën e studimeve letrare, kulturore dhe historike.



Një pjesë e rëndësishme e programit iu kushtua njohjes me veprimtarinë dhe arritjet e institucioneve shkencore të AMEA-s në fushën e digjitalizimit dhe inteligjencës artificiale si dhe shkencave natyrore.

Gjithashtu delegacioni realizoi një vizitë në Bibliotekën Qendrore Shkencore të AMEA-s, ku u pritën nga drejtori i saj, Huseyn Huseynov. Diskutimet u përqendruan në shkëmbimin e publikimeve shkencore, digjitalizimin e fondeve dokumentare, zhvillimin e infrastrukturës së informacionit shkencor dhe promovimin e aksesit të hapur në rezultatet e kërkimit.

Një vend të veçantë në agjendën e takimeve zuri edhe vizita në Universitetin Sllav të Bakusë, ku delegacioni u prit nga rektori, prof. Anar Naghiyev. Delegacioni u njoh me punën dhe arritjet e programit të gjuhës shqipe, të hapur rishtas pranë Departamentit të

Studimeve Ballkanike të këtij universiteti. Palët ranë dakord për mbështetje të ndërsjellë në forcimin e këtij programi studimi përmes shkëmbimit të specialistëve të fushës së gjuhësisë dhe të disiplinave të tjera përkatëse. Gjatë të gjitha takimeve u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërkademi si një instrument i rëndësishëm për avancimin e dijes shkencore, nxitjen e mobilitetit akademik dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore. Palët shprehën gatishmërinë për të thelluar më tej marrëdhëniet institucionale dhe për të zgjeruar bashkëpunimin në fusha me interes të përbashkët.

Një moment i rëndësishëm i vizitës ishte nënshkrimi, më 23 qershor, i Memorandumit të Mirëkuptimit për Bashkëpunim Shkencor ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit.

Vizita u zhvillua në një frymë mirëkuptimi, respekti reciprok dhe vlerësimi të ndërsjellë, duke konfirmuar angazhimin e të dy institucioneve për forcimin e lidhjeve akademike dhe promovimin e bashkëpunimit shkencor në nivel ndërkombëtar.



U mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare “Kur toka flet me emra” – Hapësira si kujtesë



- Akad. Gjinushi: “Thirre vendin tënd”, model bashkëpunimi ndërdisiplinor për toponimet dhe trashëgiminë kulturore shqiptare

Ditën e sotme, në sallën “Aleks Buda” u mbajt konferenca shkencore kushtuar antropologjisë gjuhësore dhe toponimisë.

Kjo veprimtari shkencore u organizua nga Instituti i Antropologjisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

Veprimtaria u zhvillua me pjesëmarrjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sh.T.Z. Bajram Begaj, Kryetarit të Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi, anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, nënkryetarit të komunës Arbëreshe të Ururit (Itali) dr.Emiliano Plescia, drejtoreshës së përgjithshme të AKKSHI-t znj. Daniel Pirushi. Gjithashtu konferenca përbashkoi edhe një numër të konsiderueshëm studiuesish të fushave të antropologjisë gjuhësore, gjuhësisë dhe letërsisë nga vendi dhe jashtë tij. Të pranishëm ishin dhe një numër i konsiderueshëm mbledhësish vendorë, kryesisht nga rajonet e Dibrës, Korçës, Pogradecit, Elbasanit e Roskovecit etj.

Konferenca kishte për qëllim të përshfaqte thelbin e këtij projekti i cili e konsideron hapësirën shqipfolëse brenda dhe jashtë kufijve të saj jo thjesht si një listë emërtesash dhe emra vendesh por si mbartëse e vijuar e kujtesës sonë gjuhësore, historike e antropologjike.

Punimet e konferencës u hapën dhe moderuan nga prof. asoc. dr. Olsi Lelaj, drejtor i Institutit të Antropologjisë. Në fjalën e tij ai theksoi se toponimet mbartin kujtesën historike, shoqërore dhe kulturore të komuniteteve dhe përbëjnë një mënyrë përmes së cilës brezat kanë lënë gjurmët e tyre në territor. Ai e cilësoi projektin “Thirre vendin tënd” si një shembull të suksesshëm të lidhjes së kërkimit shkencor me shoqërinë, duke veçuar përfshirjen e komuniteteve në mbledhjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Gjithashtu, ai nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit me komunitetet arbëreshe dhe vlerën e dokumentimit të emërvendeve si pjesë e kujtesës kolektive.



Konferenca u përshëndet nga Presidenti i Republikës, z. Bajram Begaj. Në fjalën e tij, presidenti Begaj e cilësoi këtë aktivitet si një ngjarje me domethënie të veçantë për shkencën dhe identitetin kulturor shqiptar. Vlera e studimit të toponimeve nuk është thjesht një ushtrim akademik, por një mënyrë për të njohur më thellë vetveten dhe për të ruajtur kujtesën kolektive të komuniteteve. Vetë titulli i kësaj konferencës, “Kur toka flet me emra”, tha presidenti Begaj shpreh qartë se emrat e vendeve janë dëshmi të gjalla të marrëdhënies midis njeriut dhe territorit, duke mbartur historinë, traditat dhe përkatësinë kulturore. Ai theksoi se kjo trashëgimi përbën një vlerë të shtuar në rrugën evropiane të Shqipërisë, pasi Bashkimi Evropian nuk synon shpërbërjen e kulturave kombëtare, por ndërtimin e një hapësire të përbashkët mbi bazën e shumëllojshmërisë dhe bashkëjetesës së traditave.

Presidenti Begaj e konsideroi përfshirjen e komuniteteve arbëreshe si një zgjedhje të domosdoshme, duke i cilësuar ato si dëshmi të gjallë të qëndresës kulturore shqiptare. Ai përmendi gjuhën, këngët dhe zakonet e ruajtura ndër shekuj si prova të lidhjes së pandërprerë me origjinën. Presidenti shprehu gjithashtu mbështetje për zgjerimin e projektit në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe më gjerë, duke theksuar se një hartë e kujtesës shqiptare nuk mund të jetë e plotë pa këto hapësira.



Veprimtaria u përshëndet dhe nga Kryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi, i cili vlerësoi praninë e Presidentit të Republikës si një mbështetje të rëndësishme për zhvillimin e shkencës dhe për vetë Akademinë. Ai theksoi se projekti “Thirre vendin tënd”, i drejtuar nga prof. asoc. Ledi Shamku-Shkreli dhe prof. dr. Merita Sauku-Bruci, jo vetëm për temën që ai trajton, pra toponimet, të cilat nuk janë thjesht emra vendesh por bashkë me to mbartin historinë, gjuhën, natyrën e kulturën përkatëse, por edhe për karakteristikat e mesazhet që ai përcjell, të cilat në vetvete ishin dhe janë arsyeja pse u ndërmor reforma e ASH-së e krahas saj ajo për reformimin e sistemit tonë shkencor e që përbejnë synimin kryesor të tyre.

Projekti ka arritur të ndërthurë arritjet e studiuesve pararendës me metodologjitë më të

përparuara ndërkombëtare, duke u shtrirë në të gjithë vendin përmes një rrjeti mësuesish, nxënësish dhe mbledhësish të traditës. Ai kujtoi se në arkivat e Akademisë ruhen mbi 250 mijë skeda toponimesh dhe mikrotoponimesh të mbledhura ndër dekada dhe se projekti ka ringjallur një traditë të vyer kërkimore të viteve '70-'80.

Ai e cilësoi atë si model të bashkëpunimit ndërdisiplinor, ku gjuhësia, historia, arkeologjia, botanika, gjeografia, madje edhe gjenetika dhe inteligjenca artificiale bashkohen për të arritur synime të përbashkëta. Gjithashtu, ai e lidhi këtë përvojë me projektet madhore të albanologjisë, si "Fjalori i Madh i Gjuhës Shqipe", "Enciklopedia Shqiptare" dhe "Historia e Shqiptarëve".

Në përfundim të fjalës së tij, akad. Gjinushi theksoi se Shqipëria ka detyrimin të përmbushë standardet evropiane në fushën e shkencës, si për numrin e kërkuesve shkencorë, ashtu edhe për nivelin e financimit, duke vlerësuar mbështetjen e Presidentit si një faktor kyç për realizimin e këtyre synimeve.



Në përshëndetjen e saj drejtuar punimeve të kësaj konference, drejtoresha e AKKSHI-t, znj. Daniel Pirushi, ritheksoi mbështetjen e institucionit për projektet kërkimore në fushën e albanologjisë dhe trashëgimisë kulturore, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional me Akademinë e Shkencave.

Në mesazhin e tij përshëndetës, drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, akad. Valter

Memisha, vlerësoi konferencën si dëshmi të rëndësishë së studimeve toponomastike dhe të karakterit ndërdisiplinor të albanologjisë. Ai theksoi se punimet e paraqitura vijnë nga traditën e studimeve të njohura shqiptare në këtë fushë dhe se projekti i mbështetur nga AKKSHI ka krijuar mundësi të reja për kërkim shkencor dhe bashkëpunim akademik. Nën kryetari i Komunitetit të Ururit (Molise, Itali), z. Emiliano Plescia, u shpreh tejet i emocionuar për praninë e tij në këtë konferencë, në vazhdë të marrëdhënieve të ngushta e të kahershme me institucionet e Antropologjisë dhe studiuesit e saj dhe vlerësoi këtë si mundësi të artë bashkëpunimin me institucionet shqiptare për ruajtjen e gjuhës, traditave dhe identitetit kulturor arbëresh të pandarë nga ai shqiptar brenda kufijve politikë të Republikës së Shqipërisë. Ai u ndal veçanërisht në ritin e përveçëm që i karakterizon arbëreshët e Ururit e ashtuquajtura “Corsa dei carri” - “Rrjedhja e qerreve”, duke theksuar se përmes nënshkrimit të sotëm të marrëveshjes së bashkëpunimit mes komunitetit të Ururit dhe Institutit të Antropologjisë pjesë e ASHSH-së po hidhet një hap historik në synimin e përbashkët për ta renditur këtë rit si pjesë e trashëgimisë botërore UNESCO. Fjala e tij u pasua nga nënshkrimi dypalësh i marrëveshjes së bashkëpunimit mes Institutit të Antropologjisë dhe Komunitetit të Ururit (Molise, Itali). Një tjetër hap i rëndësishëm drejtë realizimit të një prej synimeve parësore të akademisë së shkencave, ai i shkencës së hapur që certifikimi i 70 mbledhësve të parë që kanë kontribuar në lëndën e parë të këtij projekti, të cilët u vlerësuan me certifikatën “Mbledhës Tradite”.



Punimet shkencore u zhvilluan në tri sesione tematike. Paneli i parë trajtoi toponomastikën si një fushë ku ndërthuren gjuhësia, historia dhe antropologjia, duke sjellë qasje metodologjike dhe analiza mbi toponimet shqiptare.

Paneli i dytë iu kushtua projektit “Thirre vendin tënd”, ku u prezantuan të gjitha punimet e deritanishme të shkollave, mësuesve dhe nxënësve të cilët folën në vetë të parë duke paraqitur rezultate konkrete në kërkimet vendore mbi mikrotoponimet dhe rolin e tyre në ruajtjen e identitetit lokal dhe të trashëgimisë gjuhësore.

Në panelin përmbyllës, “Zëri i vendeve”, studiuesit paraqitën punime që ndërthurën kërkimet arkivore, dëshmitë gojore dhe interpretimet historike e letrare të toponimeve.

Konferenca u mbyll me përfundimet e Laboratorit të Antropologjisë Gjuhësore, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërdisiplinor për dokumentimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore e gjuhësore shqiptare.



Fjala e Kryetarit të ASHSH-së, akad. Skënder Gjinushi, në konferencën shkencore ndërkombëtare: “Kur toka flet me emra – Hapësira si kujtesë”



Në konferencën shkencore ndërkombëtare “Kur toka flet me emra – Hapësira si kujtesë”, Kryetari i Akademisë së Shkencave theksoi rëndësinë e projektit si një model i bashkëpunimit ndërdisiplinor dhe i rizgimit të traditës më të mirë kërkimore.

Më poshtë fjala e plotë e Kryetarit të ASHSH, akad. Skënder Gjinushi:

I nderuar Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Z. Bajram Begaj,

Të nderuar akademikë, profesorë e të ftuar,

Duke ju uruar të gjithëve mirëseardhjen në këtë konferencë ku do të paraqiten ecuria dhe rezultatet e projektit “Thirre vendin tënd”, më lejoni të përshëndes në veçanti prezencën e Presidentit të Republikës duke e vlerësuar atë si mbështetje për zhvillimin e shkencës në tërësi, e posaçërisht për Akademinë e Shkencave e strukturave pranë saj e për tërë kërkuesit e studentët.

Projekti, objekt i këtij aktiviteti, i drejtuar nga Ledi Shanku e Merita Bruci, me financim të AKKSHI-së e mbështetjen e dy instituteve, atë të Antropologjisë e Gjuhësisë, ka një vlerë të veçantë jo vetëm për temën që ai trajton, toponimet, të cilat nuk janë thjesht emra vendesh por bashkë me to mbartin historinë, gjuhën, natyrën e kulturën përkatëse, por edhe për karakteristikat e mesazhet që ai përcjell, të cilat në vetvete ishin

dhe janë arsyeja pse u ndërmor reforma e ASH-së e krahas saj ajo për reformimin e sistemit tonë shkencor e që përbejnë synimin kryesor të tyre.

Projekti i mbështetur në metoda e metodologji të reja të shoqëruara me teknologjinë e duhur nuk synoi që në emër të tyre të mohojë arritjet e studimet e mëparshme, por ka arritur që nëpërmjet metodës së re të bashkojë me respekt arritjet e studiuesve tanë pararendës me zhvillimet më të përparuara të kërkimeve ndërkombëtare në këtë fushë. Në arkivat e Akademisë së Shkencave ruhen sot mbi 250 mijë skeda toponimesh e mikrotoponimesh, të mbledhura ndër dekada nga etnografë, gjuhëtarë, historianë, mësues, inxhinierë toke e pyjesh, por edhe nga njerëz të thjeshtë.

Projekti nuk u kufizua brenda mureve të Akademisë së Shkencave. Përkundrazi, duke besuar te shkenca e hapur, që është edhe një nga misionet themelore të vetë Akademisë, projekti u shtri në të gjithë vendin nëpërmjet një rrjeti të gjerë mësuesish, nxënësish, bashkëpunëtorësh dhe mbledhësish tradite, duke ringjallur një nga traditat më të bukura të Akademisë së Shkencave të viteve '70-'80.



Projekti u shtri tej kufijve të Shqipërisë deri në Arbëri çka përben një prej synimeve e politikave të ASH-së në ngritjen e organizimin e njësive të reja e ndërmarrjen e projekteve madhore si po veprohet për tre projektet madhore të Albanologjisë, Fjalori i madh i gjuhës shqipe, Enciklopedia shqiptare dhe Historia e shqiptarëve.

Projekti është një dëshmi e prirjeve kryesore të kohës, asaj që projektet nuk mund të kufizohen brenda një disipline, se bashkëpunimi ndërdisiplinor është një domosdoshmëri edhe në fushat e albanologjisë. Një projekt për emrat e vendeve, në

dukje tepër i specializuar iu desh të ftojë gjuhësinë, historinë, arkeologjinë, e mandej edhe botanikën, hidrikën, agronominë dhe gjeografinë, për të arritur synimet e tij. Dy nga punimet më të rëndësishme e më të fundit që lidhen me konfirmimin e origjinës e lashtësisë së gjuhës e ADN-së shqiptare ku morën pjesë dhe specialistë shqiptarë e të ASH-së janë produkt ekipesh ndërdisiplinore, përfshirë gjenetikën e inteligjencën artificiale.

Pra projekti është një model, që krahas shumë projekteve të ndërmarra me financim të Akademisë e të AKKSHI-t vërtetojnë pse ishte e është i nevojshëm afrimi e koordinimi i kërkimit shkencor tek ne, nëpërmjet ngritjes së një rrjeti institutesh e qendrash kërkimore, pranë ASH-së, sigurisht në bashkëpunim të ngushtë e të pandarë me IAL-të. Riorganizimi i njësive ekzistuese, krijimi për to i kushteve të nevojshme, si në logjistikë e për kapacitetet njerëzore, rritja e kërkesës e kriterëve të vlerësimit të punonjësve kërkimorë-shkencorë, sipas standardeve të kohës, shoqëruar me rritjen e trajtimit të tyre financiar, si dhe ngritja e njësive të reja në fushat kryesore të dijes si bio e nanoteknologji janë bërë të mundura nga kjo përvojë e fituar e kushtet e krijuara gjatë viteve të fundit.

Shqipëria ka detyrimin të plotësojë arritjet europiane dhe në fushën e shkencës, si për numrin e kërkuesve, ashtu dhe për nivelin e financimit në raport me GDP-në; ne si ASH, gjithë personeli kërkimor e komisionet kanë detyrimin të krijojnë kushtet e të rekomandojnë masat për thithjen e tyre në mënyrë efektive. Patjetër, ky detyrim i përbashkët do mirëkuptimin e përkrahjen e politikës e veçanërisht të ekzekutivit. Ne përshëndesim faktin se kemi mbështetjen tuaj z. President. Kjo vlen shumë në kushtet e mjedisit tonë ku ende në emër të politikës, segmenteve të saj, disa ngatërrojnë nivelin e doktoratës së tyre me atë të kërkimit shkencor në Shqipëri e të pjesës kryesore të personelit akademik tek ne a pranë IAL-ve. Në radhët e tyre ka njerëz të talentuar të nivelit të homologëve të tyre në Europë, përveç kësaj, tani janë mundësitë të afrojmë e përfitojmë nga diaspora jonë shkencore, disa prej tyre janë tashmë në krye të drejtimit të njësive tona. Tërë komunitetet që përmendet Ju, i nderuar z. President, janë pjesë e projektit të Enciklopedisë së ASHSH-së.

Duke përfunduar dëshiroj të përshëndes drejtuesit e projektit për punën e lavdërueshme, të falënderoj e përgëzoj bashkëpunëtorët e tyre vullnetarë. Drejtuesen e AKKSHI-së e vetë institucionin për bashkëpunimin e ngushtë prej 5 vitesh që ka mundësuar mbështetjen e dhjetëra projekteve në bashkëpunim me IAL-të, dy drejtuesit e instituteve që gjetën gjuhën e përbashkët për t'i krijuar kushtet Ledit, gjë që nuk është e lehtë për ndërmarrjen e këtij projekti, që priste me kohë të rrugëtonte, dhe të shpreh edhe një herë nderimin që i behet institucionit e gjithë të pranishmeve me prezencën e përshëndetjen e Z. President.

Akademia e Shkencave mbështet kërkesat e shqetësimet e drejta të shqiptarëve të Preshevës dhe është e gatshme të bashkëpunojë për adresimin e tyre



Kryetari i ASH-së, kryesia e saj dhe drejtorët e instituteve të albanologjisë pranë Akademisë së Shkencave, në takim me kryetaren e Komunës së Preshevës, znj. Ardita Sinani e shoqëruar nga prof. dr. Ilir Zylfiu, u njohën nga afër me problemet e shqetësimet me të cilat përballet komuniteti shqiptar në këtë rajon, me politikat që synojnë shpopullimin gradual e të heshtur të tij, siç janë: çështja e mosnjohjes së diplomave të dhëna nga universitetet e Kosovës; punësimi i funksionarëve e specialistëve të lartë mbi kriteret e preferencave etnike në të gjitha fushat e sektorët; nxitja e emigrimit të detyruar të rinjve; politika e pasivizimit të adresave të qytetarëve me alibi ligjore jashtë çdo praktike e standardi evropian, të shoqëruara këto me një politikë diskriminuese në drejtim të zhvillimit ekonomik, arsimor e kulturor të rajonit, në raport me zonat e tjera, si dhe në trajtimin e çështjeve që lidhen me historinë, kulturën e trashëgiminë e shqiptarëve.

Në takim u theksua se nevojitet një bashkëpunim i ngushtë midis institucioneve kryesore akademike, arsimore e ekzekutive, pasi, me gjithë përpjekjet e ndërmarra deri më tani

për ndërkombëtarizimin e problematikave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës e më gjerë, në organizma dhe institucione ndërkombëtare, si: Organizata e Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Evropës dhe Parlamenti Evropian, përsëri ato nuk kanë gjetur zgjidhjen e duhur.



Mbi këtë bazë ASH-ja shpreh mirëkuptimin e mbështetjen e plotë për shqetësimet e problematikave të ngritura në takim, me përpjekjet e kërkesën për garantimin e lirive e të drejtave themelore për shqiptarët në Luginën e Preshevës, sipas standardeve e konventave europiane për pakicat kombëtare; për pozitën e tyre si qytetarë të barabartë në shtetin ku jetojnë; për gëzimin prej tyre të po atyre të drejtave individuale, institucionale, kombëtare e vetëqeverisëse, siç kërkohen e garantohen për pakicat në Kosovë e kudo në Europë.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë shpreh gatishmërinë për angazhimin e saj dhe të strukturave pranë saj për të bashkëpunuar në evidentimin e adresimin me argumente shkencore të problemeve të mësipërme, veçanërisht të atyre që lidhen me historinë, kulturën e arsimin, si dhe për shtrimin e rrugëzgjdhjeve pranë institucioneve kompetente kombëtare a ndërkombëtare.

Ajo vlerëson se organizimi i një strukture të posaçme do të ndihmonte e lehtësonte koordinimin e bashkëpunimit midis saj e institucioneve të tjera, e posaçërisht me drejtuesit e institucionet e komunës e të komunitetit.

**Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi
takoi dr. Bruno Kragić, drejtorin e Rrjetit European të Enciklopedive**



Përpara nisjes së punimeve të konferencës shkencore ndërkombëtare dyditore me temën: "Enciklopedizmi dhe bota shqiptare", kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, pati një takim kortezie me dr. Bruno Kragić, drejtor i Rrjetit European të Enciklopedive dhe drejtor i përgjithshëm i Institutit Leksikografik "Miroslav Krleža".

Konferenca është e para e këtij lloji e organizuar nga Akademia e Shkencave dhe prania e përfaqësuesve të Rrjetit European të Enciklopedive merr vlerë të veçantë, jo vetëm për kontributin shkencor që sjell, por edhe për ndërtimin e urave të reja të bashkëpunimit."

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë e njohu dr. Bruno Kragić-in me zhvillimet që ka marrë Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike (QBEA) dhe nënvizoi rolin kryesor të njërit nga projektet më të rëndësishme, që është Enciklopedia. Ai theksoi se pranimi i Qendrës në Rrjetin European të Enciklopedive ka qenë shumë pozitiv dhe përfshirja në aktivitetet e këtij rrjeti është gjithmonë e mirëpritur.

Gjithashtu drejtori i Rrjetit European të Enciklopedive u njoh me zhvillimet e punimeve të projektit, ku Enciklopedia përfshin të gjitha trevat shqipfolëse, duke bërë së bashku studiues që kontribuojnë në hartimin e këtij projekti madhor.

Akad. Gjinushi e informoi dr. Brunon edhe me punën dhe rolin e redaksisë qendrore dhe redaksive vendore, si dhe me kriteret e vendosura dhe rezultatet e arritura deri më tani. Ai theksoi që synimi i këtij projekti madhor është që "Enciklopedia shqiptare" të jetë edhe në versionin online, i përdorshëm nga të gjithë.

Takimi shërbeu për të njohur më mirë mundësitë e bashkëpunimit mes Qendrës dhe Rrjetit European të Enciklopedive. Nga të pranishmit u theksua rëndësia e përfshirjes së QBEA-së në të gjitha veprimtaritë shkencore që organizohen në kuadër të Rrjetit European të Enciklopedive.

U mbajtën punimet e konferencës së parë shkencore ndërkombëtare kushtuar enciklopedizmit shqiptar



Sot, më 29 qershor 2026, nisi punimet konferenca shkencore ndërkombëtare “Enciklopedizmi dhe bota shqiptare”, një veprimtari e organizuar nga Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, njësi e përhershme e kërkim-studimit pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, anëtare me të drejta të plota në Rrjetin European të Enciklopedive dhe të Bibliotekës Kombëtare.

Kjo është konferenca e parë që i kushtohet tërësisht kësaj tematike, ndaj kumtesat dhe diskutimet e paraqitura paraqesin një interes të veçantë, sidomos në kuadër të punës që po zhvillohet për hartimin e “Enciklopedisë Shqiptare”, një nismë e përbashkët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Konferenca u moderua nga drejtori i Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, z. Andreas Dushi, i cili paraqiti procesin e hartimit të “Enciklopedisë Shqiptare”.

Veprimtarinë e përshëndeti kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe kryeredaktori i “Enciklopedisë shqiptare”, akad. Skënder Gjinushi. Ai foli për qëllimin kryesor të konferencës, ku nënvizoi shkëmbimin e përvojave në fushën e enciklopedizmit, një fushë relativisht e re për institucionet shqiptare, sidomos në tre-katër vitet e fundit, ku Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe

Arteve të Kosovës kanë ndërmarrë projektin e përbashkët për hartimin e enciklopedisë kombëtare.

Akad. Gjinushi nënvizoi më tej, se vizioni për Qendrën e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike shkon përtej përgatitjes së një enciklopedie apo fjalori të madh. Ajo synon të shndërrohet në një qendër të përhershme kërkimore pranë Akademisë së Shkencave, e mbështetur në një rrjet të gjerë specialistësh nga fusha të ndryshme, të cilët do të kontribuojnë në hartimin, redaktimin, përditësimin dhe pasurimin e vazhdueshëm të botimeve enciklopedike. Ai theksoi se enciklopedia nuk është një vepër që përfundon me botimin e saj, por një projekt që kërkon mirëmbajtje, përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm.



Punimet e konferencës u përshëndetën edhe nga akad. Frashër Demaj, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, i cili vlerësoi organizimin e kësaj veprimtarie si një mundësi të rëndësishme për prezantimin e studimeve, shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit

akademik.

Drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare, znj. Majlinda Toçi, e cilësoi organizimin e konferencës një nismë sa ambicioze, aq edhe të domosdoshme, duke e parë si një moment historik për albanologjinë dhe kulturën shkencore shqiptare.

Veprimtaria u zhvillua në dy seanca. Seanca e parë përfshiu ceremoninë e hapjes, fjalët përshëndetëse dhe kumtesat e para. Më pas, seanca e dytë u organizua paralelisht në tri salla të ndryshme. Në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u mbajtën seancat me temat: “Një vështrim historik rreth dijes enciklopedike shqiptare” dhe “Tematikat në enciklopedi dhe veçori të enciklopedizmit në botën shqiptare”. Në sallën “Akademikët” (ASHSH) u zhvillua seanca me temën “Standardizimi gramatikor dhe historik i enciklopedizmit shqiptar”, ndërsa në auditorin e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë u mbajt seanca “Enciklopedizmi dhe bibliotekonomia.



Dr. Bruno Kragić drejtor i Institutit “Miroslav Krleža” dhe Rrjetit European të Enciklopedive, trajtoi çështjen e hartimit të enciklopedisë universale. Më tej, drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare, znj. Majlinda Toçi, foli mbi rolin e fondit kombëtar dhe kalimin drejt enciklopedive digjitale. Drejtori i QBEA-së, z. Andreas Dushi, paraqiti procesin e hartimit të “Enciklopedisë Shqiptare”. Një kumtesë e veçantë ishte edhe ajo e akad. Vasil S. Toles, zv. kryetar i ASHSH-së, i cili solli tipologjitë dhe modelet e enciklopedizmit

muzikor në botën shqiptare.

Seanca “Tematikat në enciklopedi dhe veçori të enciklopedizmit në botën shqiptare” vijoi me kumtesën e Azis Pollozhanit, i cili prezantoi rolin e redaksisë së posaçme për Maqedoninë e Veriut në ndërtimin e kujtesës kolektive dhe identitetit kombëtar; Frashër Demaj analizoi versionin shqip të “Enciklopedisë së Jugosllavisë”; Marin Haxhimihali solli në kujtesën e të pranishmëve figurën e Sami Frashërit si urë kulturore midis Lindjes dhe Perëndimit; ndërsa akad. Shaban Sinani trajtoi stabilizimin e ligjërit enciklopedik shqip.



Në vijim, akad. Dhimitër Haxhimihali paraqiti kategoritë teknologjike në “Enciklopedinë shqiptare”; Mimoza Priku foli për toponiminë dhe onomastikonin historik si përveçime për enciklopedinë; Vehbi Miftari solli perspektivën e Vatikanit mbi burimet referenciale shqiptare.

Në sallën “Akademikët” u zhvillua seanca me temën “Standardizimi gramatikor dhe historik i enciklopedizmit shqiptar”, ku u trajtuan çështje të transkriptimit dhe

transliterimit të emrave të huaj në shqip nga prof. dr. Valbona Toska dhe dr. Mirushe Hoxha. Më tej u trajtuan elementët enciklopedikë në veprat e Ndre Mjedës nga dr. Zamira Shkreli e Erzen Kopëraj. Gjergj Sinani trajtoi dukurinë e paragjykimeve në shkrimin e historisë së një kombi, ndërsa prof.dr. Naser Zabeli vuri në dukje disa nga problematikat e terminologjisë pedagogjike e didaktike. Arbenita Morina paraqiti një analizë të thelluar mbi ndryshimet në diskursin e përkthimit enciklopedik nga anglishtja në shqip.

Ndërkohë, në Auditorin e Bibliotekës Kombëtare u mbajt seanca me temën “Enciklopedizmi dhe bibliotekonomia”, ku akad. emeritus Gjovalin Shkurtaj trajtoi temën e të shkruarit si proces krijues dhe Luan Topçiu trajtoi imagologjinë dhe njohjen e tjetrit përmes botimeve albanologjike në kontekstin rumun. Elsa Bitri prezantoi organizimin bibliografik dhe fizik të enciklopedisë në Bibliotekën Kombëtare. Kumtesat e tjera sollën problematika të historisë së teatrit nga Anxhela Çikopano, si dhe përfaqësimin e shqiptarëve në enciklopedi të huaja nga Zeqirja Ibrahim. Për rolin e botimeve arbëreshe foli Vilma Proko. Çështje të tjera të rëndësishme si qasjet e reja mbi digjitalizimin, ndërmjetësimin kulturor dhe bibliografitë tematike lokale u trajtuan nga Alda Banushi, Jola Tasellari, Irena Buzi, Eglantina Shtylla, Elton Gjurma, Eris Rusi, Beneta Dhima.

Mbylli punimet konferenca e parë shkencore ndërkombëtare kushtuar enciklopedizmit shqiptar



Sot, më 30 qershor 2026 u zhvillua dita e dytë e punimeve të konferencës shkencore ndërkombëtare “Enciklopedizmi dhe bota shqiptare”.

Në këtë sesion morën pjesë autorët, redaktorët dhe bashkëpunëtorët e projektit madhor “Enciklopedia shqiptare, me synimin për të shkëmbyer përvojat dhe përcaktuar detyrat për harmonizimin e qasjeve mbi metodën e punës.

Akad. Shaban Sinani, drejtuesi i redaksisë vendore Tiranë dhe përgjegjës i sektorit të Enciklopedisë shqiptare, udhëhoqi një bashkëbisedim mbi mënyrat praktike të hartimit të artikujve enciklopedikë, duke vënë në pah metodën e njësuar që do të garantojë cilësinë dhe duke nënvizuar kriteret e standardet që do të udhëheqin projektin madhor “Enciklopedia shqiptare”.

Ai theksoi se njësimi teknik dhe respektimi i traditës enciklopedike shqiptare e ndërkombëtare, i japin projektit një bazë të fortë shkencore dhe institucionale dhe janë themel për garantimin e cilësisë dhe autoritetit shkencor, duke i dhënë projektit madhor “Enciklopedia shqiptare” bazën e nevojshme metodologjike.

Takimi i ditës së dytë u konceptua si një forum i hapur, ku redaktorët dhe bashkëpunëtorët e përfshirë në këtë nismë diskutuan mënyrat e titullimit, strukturimit të tekstit, citimit të burimeve dhe përfshirjes së bibliografisë, si dhe rolin e ilustrimeve në

pasurimin e artikujve.

Në ditën e parë u trajtuan çështje të rëndësishme të enciklopedizmit shqiptar për më shumë lexo linkun; <https://www.facebook.com/share/p/17h7ZYdGHR/>

Konferenca dyditore u mbyll me udhëzimet për titullimin e artikujve, strukturën e tekstit, mënyrat e citimit dhe bibliografisë, si dhe rolin e ilustrimeve në pasurimin e përmbajtjes.

Për më shumë klikoni linkun: <https://youtu.be/735bjRZHnag>
www.akad.gov.al

Nisi punimet konferenca e 4-t ndërkombëtare për shëndetin publik dhe mjedisin



Sot, më 22 qershor 2026, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë nisën punimet e konferencës ndërkombëtare dyditore për shëndetin publik dhe mjedisin. Veprimtaria u organizua nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, nëpërmjet Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (ASHSH) dhe Njesisë kërkimore “Pasuritë Ujore” (ASHSH), në bashkëpunim me Universitetin George Mason (SHBA) dhe kolegjin Ramazzini (Itali).

Konferenca, e cila do të vijojë edhe në datën 23 qershor 2026, ka mbledhur studiues, ekspertë dhe përfaqësues institucionesh nga Shqipëria dhe vende të tjera. Edicioni i katërt i kësaj veprimtarie synon të promovojë dialogun shkencor dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e shëndetit publik dhe mjedisit, duke adresuar ndikimin e cilësisë së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike në shëndetin e njeriut.

Konferenca u moderua nga akad. Besnik Bare, drejtues i njesisë kërkimore-studimore “Pasuritë ujore”. Ai e vlerësoi si të domosdoshme konferencën dhe përqendrimin e saj në sfidat aktuale që lidhen me cilësinë e mjedisit, ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre në shëndetin e njeriut.

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil Tole, në fjalën përshëndetëse theksoi se qëllimi i përbashkët i konferencës është forcimi i kuptimit shkencor dhe bashkëpunimit për të përballuar sfidat globale që kërcënojnë shëndetin dhe mjedisin. Ai nënvizoi lidhjen e ngushtë mes cilësisë së mjedisit dhe shëndetit të popullatave, duke theksuar se ndotja e ajrit e ujit, siguria ushqimore, ndryshimet klimatike dhe sëmundjet e reja infektive nuk janë më çështje të izoluar, por problematika që kërkojnë përgjigje të koordinuara në nivel shkencor, institucional dhe shoqëror.

Akad. Tole vuri në dukje se Akademia e Shkencave e ka prioritet promovimin e ekselencës shkencore dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, duke e konsideruar këtë

konferencë si vazhdim të një partneriteti të suksesshëm me Universitetin George Mason. Ai theksoi se temat e trajtuara, si cilësia e ajrit, ujit, ushqimit dhe politikat e shëndetit publik, pasqyrojnë kompleksitetin e sfidave bashkëkohore dhe domosdoshmërinë e kërkimit ndërdisiplinor. Ai shprehu bindjen se prezantimet dhe diskutimet e konferencës do të gjenerojnë ide të reja dhe politika të afta për të përmirësuar cilësinë e mjedisit dhe për të mbrojtur shëndetin publik. Në mbyllje të fjalës së tij, akad. Tole falënderoi veçanërisht prof. dr. Melissa J. Perry-n, dekanen e Shkollës së Shëndetit Publik në Universitetin George Mason (SHBA) për vizionin dhe mbështetjen e saj të vazhdueshme në avancimin e këtij partneriteti të rëndësishëm shkencor, si dhe të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e tyre.



Në vijim, akad. Anila Hoda, sekretarja shkencore e Akademisë së Shkencave, në emër të Kryesisë, i dorëzoi prof. dr. Melisa J. Perry-t diplomën “Nderi i Akademisë”. Prof. dr. Perry shprehu mirënjohje të thellë dhe shumë falënderime dhe më tej, ajo nënvizoi se Shqipëria është një vend i jashtëzakonshëm dhe është e natyrshme që të punojmë së bashku për të rritur ndërgjegjësimin për mjedisin dhe shëndetin në punë. Prof. dr. Perry vlerësoi rolin e konferencës, në ndërthurjen midis një mjedisi të

shëndetshëm dhe një popullate të shëndetshme, si çështje që po merr vëmendje ndërkombëtare.

Zëvendësministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Eugena Tomini, falënderoi organizatorët dhe nënvizoi se kriza mjedisore dhe ndryshimet klimatike po ndikojnë thellësisht në shëndetin e njeriut. Mjedisi i shëndetshëm mund të parandalojë pothuajse një të katërtën e barrës totale të sëmundjeve.

Rrektori i Universitetit të Mjekësisë, prof.dr. Xheladin Draçini, u shpreh se ndikimi i ndryshimeve mjedisore, urbanizimit dhe faktorëve socialë po bëhet gjithnjë e më i madh në shëndetin publik, ndërsa kërkimi shkencor mbetet mjeti më i fuqishëm për zgjidhje të qëndrueshme dhe të bazuara në fakte. Ai theksoi se lidhja midis mjedisit dhe shëndetit publik kërkon qasje multidisiplinare dhe bashkëpunim ndërmjet studiuesve, profesionistëve të shëndetësisë, biologëve, specialistëve të mjedisit dhe politikëbërësve.



Nga ana tjetër drejtoresha e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), znj. Blerina Gjylameti e vuri theksin tek domosdoshmëria e ndërthurjes midis fushave të ndryshme dhe u shpreh se strategjia “One Health” duhet të shihet që nga burimi i problemeve, përfshirë ndikimin e mjedisit në ushqim dhe në shëndetin publik.

Gjithashtu specialistja në Ministrinë e Mjedisit, znj. Klodiana Marika vuri në dukje bashkëpunimet ndërsektoriale dhe veprimet e integruara për cilësinë e ujit, ajrit dhe mbrojtjen e ekosistemeve dhe biodiversitetit. Ajo nënvizoi se bashkëpunimi midis institucioneve qeveritare dhe atyre akademike është thelbësor për hartimin e politikave të qëndrueshme të bazuara në të dhëna shkencore, ndërsa monitorimi mbetet një element vendimtar për cilësinë e mjedisit dhe jetës së qytetarëve.

Konferenca vijoi me prezantimet e studimeve dhe punimeve shkencore nga studiues dhe ekspertë vendas e të huaj, të cilët paraqitën gjetjet, analizat dhe zhvillimet më të fundit në fushën e shëndetit publik, mjedisit dhe shëndetit në punë. Diskutimet u

përqendruan në sfidat aktuale që lidhen me cilësinë e ajrit, ujit dhe ushqimit, ndikimin e ndotjes dhe ndryshimeve klimatike në shëndetin e njeriut, si dhe në qasjet dhe politikat e nevojshme për përballimin e këtyre sfidave.



Mbylli punimet konferenca e 4-t ndërkombëtare për shëndetin publik dhe mjedisin



Sot, më 23 qershor 2026, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë mbylli punimet konferenca e 4-t ndërkombëtare për shëndetin publik dhe mjedisin. Veprimtaria dyditore u organizua nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, nëpërmjet Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës dhe Njesisë Kërkimore “Pasuritë Ujore”, në bashkëpunim me Universitetin George Mason (SHBA) dhe Collegium Ramazzini (Itali).

Konferenca shërbeu si një platformë ndërkombëtare shkëmbimi për ekspertë të shëndetit publik, biologë, mjekë, specialistë të mjedisit dhe politikëbërës, duke vënë në qendër qasjen “One Health”, e cila thekson ndërlidhjen mes shëndetit të njeriut, kafshëve dhe ekosistemeve.

Gjatë dy ditëve të konferencës, mbi 100 kërkues shkencorë nga Shqipëria dhe vende të tjera prezantuan studime dhe rezultate kërkimore mbi cilësinë e ajrit, ujit dhe ushqimit, si dhe ndikimin e tyre në shëndetin publik.

Dita e parë e konferencës u hap me fjalët përshëndetëse të drejtuesve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe përfaqësuesve të institucioneve shkencore e publike. (Shih linkun: <https://www.facebook.com/61553652170380/posts/nisi-punimet-konferenca-e-4-t-nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare-p%C3%ABr-sh%C3%ABndetin-publik-dhe-mjedisin-as/122262273140121739/>)

Ligjërata kryesore u mbajt nga prof. Daniele Mandrioli, në emër të Collegium Ramazzini. Sesioni i parë iu kushtua shëndetit të popullatës dhe politikave shëndetësore, duke trajtuar tema aktuale si hezitimi ndaj vaksinave, sistemet e informacionit për sëmundjet jo të transmetueshme, imuniteti kundër SARS-CoV-2, përvoja nga shpërthimi i chikungunya-s në Itali, ndikimi mjedisor i dializës, problematika të ortodoncisë, si dhe lidhja ndërmjet gjelbërimit urban dhe rrezikut për sklerozën laterale amiotrofike.

Diskutimet u mbyllën me analizën e sistemit të survejancës sindromike për gripin. Në ditën e dytë, sesionet u përqendruan në cilësinë dhe sigurinë ushqimore, si dhe në cilësinë e ujit. U prezantuan studime mbi ndikimin e mikro- dhe nanoplastikës në ekosistemet ujore, sigurinë e produkteve të peshkimit, përdorimin e sensorëve të avancuar për monitorimin e ndotësve, si dhe efektet e ndryshimeve klimatike në sigurinë ushqimore.



Prof. dr. Melissa J. Perry, dekane e Shkollës së Shëndetit Publik në Universitetin George Mason, mbajti ligjëratën kryesore mbi rolin e inteligjencës artificiale në kërkimin mjedisor dhe përgjegjësitë etike që lidhen me përdorimin e saj në shëndetin publik.

Në sesionin përmbyllës, u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe e kërkimit multidisiplinar për përballimin e sfidave globale që lidhen me ndotjen, ndryshimet klimatike dhe sëmundjet e reja.

Punimet e prezantuara mbuluan një gamë të gjerë çështjesh që lidhen me shëndetin publik dhe cilësinë e mjedisit. Diskutimet nxorën në pah ndikimin e ndotjes urbane në jetën e përditshme, sfidat e menaxhimit të mbetjeve dhe riciklimit, politikat e energjisë së pastër, si dhe nevojën për ruajtjen e biodiversitetit. U theksua gjithashtu roli i institucioneve akademike në ndërgjegjësimin e publikut dhe u analizuan sfidat e reja të shëndetit publik, përfshirë efektet e ndryshimeve klimatike mbi komunitetet.

Në përfundim, punimet dhe diskutimet e zhvilluara nxorën në pah praktikat më të mira për bashkëpunimin ndërinstitucional dhe rëndësinë e politikave të qëndrueshme për të ardhmen. Organizatorët njoftuan se rezultatet e konferencës do të publikohen në një libër proceedings (vëllim të veçantë) me ISBN, duke dokumentuar kontributet shkencore të pjesëmarrësve dhe duke shënuar një hap të rëndësishëm në forcimin e dialogut shkencor ndërkombëtar për shëndetin publik dhe mjedisin.

Konferenca u mbyll me mirënjohje për të gjithë pjesëmarrësit dhe me angazhimin për vijimin e bashkëpunimeve kërkimore në kuadër të projekteve të përbashkëta ndërinstitucionale.



U zhvillua konferenca shkencore ndërkombëtare me temën “Aspekte ekonomike gjatë mesjetës dhe periudhës osmane në trojet shqiptare”



Më 24 qershor 2026, u zhvillua konferenca shkencore ndërkombëtare me temën “Aspekte ekonomike gjatë mesjetës dhe periudhës osmane në trojet shqiptare”, e organizuar nga Instituti i Historisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë.

Veprimtaria mbledhi studiues nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, të cilët paraqitën rezultate të reja kërkimore mbi zhvillimet ekonomike në hapësirën shqiptare nga Mesjeta deri në fund të periudhës osmane.

Në fjalën hapëse, akad. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, vlerësoi studimet mbi historinë ekonomike si një dimension themelor për kuptimin e proceseve të zhvillimit shoqëror, politik dhe ekonomik të trojeve shqiptare. Ai theksoi se diversiteti tematik i kumtesave dhe shtrirja e tyre kronologjike dëshmojnë nivelin e konsoliduar shkencor të kërkimeve aktuale, si dhe rëndësinë e qasjeve ndërdisiplinore të mbështetura në burime dokumentare, arkeologjike, arkivore dhe kartografike.

Më tej, akad. Hoxha u ndal në rëndësinë e konsolidimit të bashkëpunimit mbarëshqiptar në fushën e albanologjisë dhe historiografisë. Sipas tij, rezultatet e kësaj konference priten të kontribuojnë jo vetëm në pasurimin e njohurive shkencore, por edhe në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në nxitjen e projekteve të përbashkëta kërkimore,

duke krijuar platforma të reja bashkëpunimi në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të historiografisë shqiptare.

Në fjalën përshëndetëse, akad. Hamit Kaba, drejtor i Institutit të Historisë (ASHSH), vlerësoi rëndësinë e kësaj nisme për studimet historike shqiptare. Ai theksoi se historia ekonomike nuk duhet kuptuar thjesht si një fushë teknike që trajton tregtinë, prodhimin apo taksat, por si një dimension interpretues i mënyrave të jetesës, organizimit shoqëror dhe zhvillimit institucional në periudha të ndryshme historike. Sipas tij, periudha osmane përfaqëson një realitet kompleks historik, të dokumentuar në burime të ndryshme, përfshirë dokumentacionin venedikas dhe kishtar, regjistrat osmanë, si dhe qasjet moderne hapësinore. Kjo shumëllojshmëri burimesh dhe metodologjish është thelbësore për ndërtimin e një tabloje sa më të plotë të zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore.



Drejtoresha e Institutit të Historisë "Ali Hadri", prof. dr. Teuta Shala, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve kërkimore shkencore. Ajo vlerësoi se nisma të tilla forcojnë lidhjet akademike në hapësirën shqiptare dhe krijojnë

mundësi të reja për zhvillimin e kërkimeve dhe shkëmbimin e përvojave shkencore.

Sipas saj, tema e konferencës përfaqëson një ndër fushat më të rëndësishme të historiografisë shqiptare, pasi Mesjeta dhe periudha osmane kanë lënë gjurmë të thella në strukturat ekonomike, në zhvillimin urban, në qarkullimin tregtar dhe në marrëdhëniet ekonomike me qendrat rajonale dhe ndërkombëtare. Kumtesat e paraqitura, sipas saj, hapin perspektiva të reja për debat shkencor dhe bashkëpunim ndërinstitutional.

Punimet e konferencës vijuan në dy seanca shkencore të drejtuara nga studiues të institucioneve organizuese. Kumtesat trajtuan një shtrirje të gjerë kronologjike, nga Mesjeta e hershme deri në periudhën moderne, duke analizuar zhvillimet ekonomike të qyteteve shqiptare si Shkodra, Durrësi dhe Drishti, si dhe rolin e institucioneve kishtare dhe zonave malore në qarkullimin ekonomik. U trajtuan gjithashtu tema të ndryshme, përfshirë investimet në qytetet ilire në kohën e Perandorit Justinian I, gjendjen ekonomike të Kryepeshkopatës së Ohrit, tregtinë e brendshme në Shkodër, potencialet ekonomike të Malësisë së Madhe, rolin e porteve mesjetare dhe lidhjet tregtare me Venedikun, ekonominë bujqësore në Kosovë, proceset e urbanizimit, tregtinë në portin e Durrësit, rolin e vakëfeve monetare në zhvillimin ekonomik lokal, marrëdhëniet agrare në Elbasan, zejtarinë në Shkup, si dhe projektet hekurudhore dhe ndikimin e tyre ekonomik e gjeopolitik në prag të Pavarësisë.

Gjatë diskutimeve u theksua roli i qyteteve mesjetare si qendra të rëndësishme të komunikimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar; rëndësia e studimeve ndërdisiplinore për njohjen e historisë ekonomike të trojeve shqiptare dhe u vu theksi në nxitjen e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kërkimore shqiptare.

Në përfundim të veprimtarisë, përgjegjësi i departamentit në Institutin e Historisë, dr. Edmond Malaj, mbajti fjalën e mbylljes, duke përmbledhur kontributet kryesore të konferencës dhe duke theksuar rëndësinë e vazhdimit të kërkimeve mbi historinë ekonomike të shqiptarëve.

U mbajt forumi me temë “Cashless Albania 2030 – Një ekonomi pa përdorimin e parasë fizike: a jemi gati?”



Sot, më 26 qershor 2026, në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë dhe i Zhvillimit të Qëndrueshëm organizoi forumin “Cashless Albania 2030 – Një ekonomi pa përdorimin e parasë fizike: a jemi gati?”.

Pjesë e aktivitetit ishte Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, anëtarët e kryesisë së saj, akademikë, personalitete të fushës së ekonomisë dhe institucioneve publike.

Veprimtaria u moderua nga kryetari i Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë dhe të Zhvillimit të Qëndrueshëm, akad. Anastas Angjeli, i cili u shpreh se forumi zhvillohet në një moment të rëndësishëm për ekonominë e Shqipërisë, me qëllim që transformimet teknologjike, për të cilat flasim, t’i mbështesim në mënyrën se si funksionojnë ekonomitë moderne, sistemet e financave, bizneset dhe vetë qytetarët. Ai theksoi se digjitalizimi nuk është një zgjedhje, as një opsion, ai është një domosdoshmëri, që do t’i shërbejë të tashmes dhe të ardhmes, në zhvillimin ekonomik të vendit.

Akad. Angjeli vuri në dukje se në këtë drejtim Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm, ku

theksohet përmirësimi i infrastrukturës së pagesave, zgjerimi i shërbimeve bankare elektronike, zhvillimi i tregut Fintech, rritja e përdorimit të telefonisë inteligjente dhe angazhimi i institucioneve publike për ofrimin e shërbimeve të digjitalizuara, të cilat kanë krijuar kushte për një transformim të rëndësishëm në mënyrën e kryerjes së transaksioneve financiare.



Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, në fjalën e tij përshëndetëse u shpreh se forumi është një sfidë komplekse, që kërkon angazhimin e të gjithëve. Akad. Gjinushi theksoi se Akademia e Shkencave e shikon këtë tematikë si një pikëtakim emergjent mes vizionit strategjik dhe realitetit tonë makroekonomik. Ai theksoi se përvoja e ka bindur se progresi kërkonte bashkëpunim të ngushtë mes dijes shkencore dhe politikave publike.

Në fund të fjalës së tij, akad. Gjinushi u shpreh se Shqipëria, si vend kandidat, ka detyrimin të harmonizojë legjislacionin dhe praktikën e saj me ato të BE-së, përfshirë edhe fushën e pagesave. Ai vuri në dukje se, sa i përket këtij drejtimi, Akademia e Shkencave

është pikërisht vendi ku mendimi shkencor takon politikat publike. Ky forum le të shërbejë si një laborator idesh ku bota akademike, Banka Qendrore, qeveria dhe sektori privat koordinojnë hapat drejt këtij objekti kombëtar.

Në vjim Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, në fjalën përshëndetëse theksoi se zgjedhja e kësaj teme për diskutim shënon një moment të rëndësishëm për agjendën e modernizimit financiar të vendit tonë. Ai u shpreh se vlerëson nismën e Komisionit të Ekonomisë pranë Akademisë së Shkencave që i kushton vëmendje kësaj çështjeje, e cila lidhet ngushtë me zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Sipas tij, kalimi drejt një ekonomie me më pak para fizike nuk është vetëm një zhvillim teknologjik, por një transformim i sistemit financiar dhe i mënyrës se si qytetarët e bizneset kryejnë pagesat.

Guvernatori vuri theksin se ky forum jep mundësinë të vlerësojmë progresin e arritur dhe sfidat që kemi përpara.

Në këtë forum u prezantuan tema që trajtuan transformimin e sistemit financiar shqiptar drejt një ekonomie me përdorim të reduktuar të parasë fizike, ndikimin e digjitalizimit në financa dhe zhvillimin e pagesave elektronike. Referuesit trajtuan aspekte të rëndësishme të këtij transformimi, duke nisur nga ndryshimi strukturor i financave shqiptare dhe paradigma e re e pagesave digjitale, perspektiva e një ekonomie pa para fizike dhe pozicionimi i Shqipërisë në vizionin “Cashless Albania 2030”.

Në veprimtari referuan prof. asoc. Dr. Niko Pano, akad. Adrian Civici, prof. asoc. Dr. Selami Xhepa, PhD. Altin Tanku nga Banka e Shqipërisë, Endrit Yzeiraj nga Ministria e Financave, Dr. Spiro Brumbulli nga Shoqata e Bankave, përfaqësues të EasyPay, UMSH, UBA, Bankës Botërore dhe institucioneve të tjera, të cilët sollën perspektiva akademike, institucionale dhe praktike mbi zhvillimin e pagesave digjitale dhe rrugëtimin drejt objektivit “Cashless Albania 2030”.

Forcohet bashkëpunimi shkencor Shqipëri-Kosovë në Gjeoshkenca, hartohet agenda e përbashkët kërkimore 2027-2030



Në datat 18-19 qershor 2026, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) në Prishtinë, u zhvillua tryeza e rumbullakët ndërkademiqe me temë "Identifikimi i fushave të interesit të përbashkët kërkimor në Gjeoshkenca". Ky aktivitet u organizua në kuadër të bashkëpunimit institucional ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) dhe ASHAK-ut, me pjesëmarrjen e gjerë të përfaqësuesve nga Universiteti "Isa Boletini" i Mitrovicës, Universiteti i Prishtinës, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, si dhe institucione të tjera partnere.

Takimin e hapi prof. dr. Enver Hamiti, i cili vuri theksin te rëndësia e ngritjes së projekteve konkrete ndërinstitucionale, harmonizimi i të dhënave dhe përfshirja e studiuesve të rinj në iniciativat e përbashkëta shkencore.

Pjesëmarrësit u përshëndetën gjithashtu nga Kryetarja e ASHAK-ut, akad. Justina Shiroka-Pula, e cila vlerësoi lart këtë tryezë për intensifikimin e bashkëpunimit akademik, si dhe nga Dekani i Fakultetit të Gjeoshkencave të Universitetit të Mitrovicës, prof. dr. Festim Kutllovci.

Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë të pranishmit i përshëndeti akad. Rrapo Ormeni përmes një fjalimi të zgjeruar. Ai nënvizoi se sfidat natyrore si tërmetet, rrëshqitjet, përmbytjet, thatësi dhe ndotja mjedisore nuk njohin kufij administrativë, ndaj dhe përgjigjja shkencore duhet të jetë e bashkërenduar.

Akad. Ormeni veçoi suksesin e projekteve të deritanishme dypalëshe për vlerësimin e rrezikut sizmik dhe unifikimin e të dhënave sizmotektonike, duke e cilësuar mikrozonimin sizmik dhe mbrojtjen e infrastrukturës si një “detyrë kombëtare”. Lidhur me teknologjitë e reja, ai specifikoi se Inteligjenca Artificiale mbetet një mjet ndihmës, burim që ndihmon por nuk zëvendëson dot gjykimin shkencor, pasi vendimet përfundimtare dhe rekomandimet për politikëbërjen u takojnë ekspertëve.



Gjatë punimeve të tryezës u prezantuan dhe u diskutuan tema me interes strategjik mbarëshqiptar, duke përfshirë gjeologjinë, tektonikën, evolucionin gjeodinamik dhe gjeorreziqet (bazuar edhe në mësimet e nxjerra nga tërmeti i 26 nëntorit 2019). Diskutimet u shtrinë mbi ndryshimet klimatike, burimet ujore ndërkufitare, mineralet kritike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe konceptin e tranzicionit post-minerar në zonat e degraduara. Një vëmendje e veçantë iu kushtua përdorimit të teknologjive të avancuara

si GIS, teledetektimi dhe modelimi 3D, ku u shpalosën mundësitë e shfrytëzimit të platformës Google Earth Engine dhe satelitëve Copernicus Sentinel për monitorimin e territorit në kohë reale.

Mbi baza praktike, studiuesit u përqendruan te domosdoshmëria e krijimit të bazave të të dhënave të harmonizuara dhe platformave të përbashkëta gjeohapësinore. Për këtë qëllim u ngritën grupe tematike pune, të cilat përcaktuan temat prioritare, propozuan koordinatorët përkatës dhe hodhën bazat e qëndrueshme për Agjendën e Përbashkët Kërkimore për periudhën 2027–2030, me synim aplikimin e përbashkët në programet evropiane të financimit.

Dita e dytë e aktivitetit vijoi me vizita studimore dhe takime institucionale në terren për të parë nga afër infrastrukturën laboratorike dhe për të koordinuar shkëmbimet shkencore.

Delegacionet vizituan Shërbimin Hidrometeorologjik të Kosovës për të diskutuar monitorimin e ujërave, Fakultetin dhe Institutin e Gjeoshkencave në Universitetin e Mitrovicës për organizimin e trajnimeve të përbashkëta, si dhe Fakultetin e Ndërtimit të Universitetit të Prishtinës me synim projektimin e bashkëpunimeve të afërta në gjeoinxhinieri.

Ky forum dyditor shërbeu si një hapësirë e rëndësishme për shkëmbimin e përvojave dhe rezultateve kërkimore, ku u konstatua se suksesi i vërtetë i kësaj tryeze do të matet në vijimësi me cilësinë e projekteve që do të aplikohen, numrin e studimeve aplikative që do të bazohen në laboratorët e njëri-tjetrit, si dhe me cilësinë e hartave dhe standardeve që do të unifikohen.

Nisi punimet konferenca shkencore me temën “Përjetësimi i heronjve dhe dëshmorëve kombëtarë për çështjen e Kosovës (1980–1999)” në Prishtinë



Sot, më 4 qershor 2026, ka nisur punimet konference shkencore dyditore me temën “Përjetësimi i heronjve dhe dëshmorëve kombëtarë për çështjen e Kosovës (1980–1999)”.

Veprimtaria u organizua nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, me pjesëmarrjen e 71 studiuesve dhe ligjëruesve nga mbarë hapësira shqiptare.

Në ceremoninë e hapjes morën pjesë autoritete të shquara, midis të cilëve ministri në detyrë i Kulturës, Rinisë dhe Sportit i Kosovës, z. Hajrulla Çeku.

Fjalën përshëndetëse e mbajtën prof. asoc. dr. Teuta Shala-Peli, prof. Arbër Hadri dhe akad. Marenglen Verli nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, i cili prezantoi kumtesën me tematikë mbi Lëvizjen Kombëtare në Kosovë në vitet '80 përmes agjencive të ATSH-së.

Sesioni i parë u fokusua tërësisht në gjenezën e rezistencës dhe lëvizjet ilegale të periudhës 1981–1992, ku u paraqitën të dhëna të reja mbi Frontin Popullor, rolin e LPK-së, demonstratat e kohës dhe mbështetjen diplomatike të shtetit shqiptar. Paralelisht me të, vëmendja u përqendrua te simbolet dhe figurat e Luftës Çlirimtare, duke shqyrtuar zanafillën e emblemës së UÇK-së, kontributin e vullnetarëve nga Shqipëria, si dhe diskursin historiografik përballë

tendencave në publicistikën e huaj.

Sesioni i dytë u ndal në aspekte të historisë sociale dhe rezistencës civile, duke analizuar dosjet e burgut si kod qëndrese, vrasjen e ushtarëve shqiptarë në kazernat e ish-Jugosllavisë, rolin e grave në pajtimin e gjaqeve, rezistencën, si dhe kontributin e rinisë studentore, mërgatës dhe muzikës si mjet mobilizimi. Gjithashtu, ligjërimet vijuan me një pasqyrë të detajuar ushtarake dhe strategjike të ndarë sipas rajoneve, ku u analizua gjerësisht roli i heronjve dhe dëshmorëve në të gjitha zonat operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës përfshirë Zonën e Drenicës, Dukagjinit, Nerodimes, Llapit, Shalës, Pashtrikut dhe Anamoravës.



Konferenca dyditore synon të forcojë dialogun shkencor mbi rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike dhe të promovojë hulumtimet që ndriçojnë kontributin e heronjve dhe dëshmorëve në rrugën e Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë.

"U zhvillua workshop-i i 5-të me temën "Nanotech Science Meets Industry: Research, Innovation and Collaboration""



Veprimtaria u zhvillua më 3 qershor 2026 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, me synimin për të diskutuar zhvillimet më të fundit në nanoteknologji dhe aplikimet e saj në sektorë me rëndësi strategjike, si dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet kërkimit shkencor dhe industrisë.

Workshop-i synoi nxitjen e dialogut dhe krijimin e mundësive të reja të rrjetëzimit ndërmjet komunitetit akademik, institucioneve kërkimore, sektorit industrial dhe partnerëve ndërkombëtarë në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit. Veprimtaria u organizua nga qendra kërkimore e nanoteknologjisë NanoAlb/ NanoBallkan pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, duke mbledhur rreth 75 pjesëmarrës, mes të cilëve akademikë, kërkues shkencorë, përfaqësues të universiteteve, institucioneve kërkimore, industrisë, biznesit dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Takimi u hap nga akad. Arben Merkoçi, drejtor i NanoAlb dhe profesor kërkimor në ICN2, i cili vlerësoi projektet "NanoAlb Ignite" dhe nënvizoi rolin e tyre në nxitjen e inovacionit, duke theksuar se bashkëpunimi midis shkencës e industrisë është rruga më e mirë për të kthyer në shoqëri investimin e bërë në kërkimin shkencor dhe për të adresuar çështje reale. Akad. Merkoçi e cilësoi workshop-in si një platformë të rëndësishme për avancimin e nanoteknologjisë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon e më gjerë.

Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, veprimtarinë e përshëndeti sekretarja shkencore akad. Anila Hoda, e cila e vlerësoi workshop-in si një hapësirë që bashkon kërkimin shkencor, inovacionin dhe industrinë në funksion të zhvillimit ekonomik e shoqëror. Ajo theksoi se nanoteknologjia dhe nanoshkencat përfaqësojnë ndër fushat më premtuese të shekullit XXI, me ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetësi, bujqësi, mbrojtjen e mjedisit, inteligjencën artificiale dhe sektorë të tjerë strategjikë.



Akad. Hoda nënvizoi se Akademia e Shkencave ka mbështetur vazhdimisht zhvillimin e fushave të reja kërkimore, duke krijuar struktura dhe iniciativa që nxisin ekselencën shkencore, inovacionin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, ndërsa NanoAlb-in e cilësoi si një histori suksesi që ka arritur të krijojë një komunitet dinamik studiuesish, të zhvillojë aktorëve të inovacionit. Duke theksuar rolin e Akademisë në mbështetjen e kërkimit të avancuar dhe transferimit të dijes drejt shoqërisë, ajo shprehu bindjen se investimi në shkencë është investim në të ardhmen dhe se nisma të tilla rrisin konkurrueshmërinë e shkencës shqiptare në hapësirën evropiane dhe ndërkombëtare.

Sesioni i parë, i moderuar nga prof. dr. Kledi Xhaxhiu, solli një varg prezantimesh shkencore dhe teknologjike. Dr. Arjan Çiftja paraqiti teknologjitë e reja për furrat e gjeneratës së ardhshme në rritjen e kristaleve të silikonit për energjinë diellore; prof. dr. Flamur Sopaj diskutoi mbi degradimin elektrokimik të herbicideve përmes nanopartikujve të oksidit të grafitit; ndërsa Endri Dhaskali, CEO i InsectIntel, prezantoi një sistem inteligjent për monitorimin e insekteve në bujqësi me përdorim të inteligjencës artificiale.



Prof. dr. Magdalena Cara prezantoi risitë e nanoteknologjisë në diagnostikimin dhe menaxhimin e patogjenëve të bimëve, ndërsa përfaqësuesit e AZ Group, Alban Zusi dhe Hitendra Mehta, sollën perspektivën e sektorit industrial mbi aplikimin e teknologjive inovative dhe bashkëpunimin me institucionet kërkimore.

Në sesionin e dytë u trajtuan tema të tjera me interes shkencor dhe aplikativ. Prof. dr. Majlinda Vasjari paraqiti një punim mbi nanobiosensorët për mbetjet e pesticideve në bujqësi dhe industri ushqimore; Elda Elmazllari prezantoi aktivitetin e laboratorëve mjedisorë. Më tej, përfaqësues nga Merck Group prezantuan sistemet e pastrimit të ujit për kërkimin shkencor, Me interes ishte edhe prezantimi i Duslan Popovic nga Thermo Scientific, i cili paraqiti përdorimet e mikroskopisë elektronike në nanoshkencë.

Workshop-i ofroi një panoramë të gjerë të zhvillimeve bashkëkohore në nanoshkencë dhe nanoteknologji, duke evidentuar potencialin e tyre për adresimin e sfidave në fusha të tilla si shëndetësia, bujqësia, siguria ushqimore, mbrojtja e mjedisit dhe inovacioni industrial. Veprimtaria krijoi gjithashtu mundësi të rëndësishme për shkëmbimin e ideve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet studiuesve, institucioneve kërkimore dhe përfaqësuesve të industrisë.

Nis sezoni kërkimor sezoni i gërmimeve arkeologjike për vitin 2026 në bazilikën paleokristiane



Në vijim të projektit kërkimor “Lagjja romake-bizantine jashtë mureve të castrum Scampis – bazilika paleokristiane (Elbasan)”, është hapur sezoni i gërmimeve arkeologjike për vitin 2026, i realizuar nga Instituti i Arkeologjisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Mozaiku i sapozbuluar i bazilikës paleokristiane u vizitua nga Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, i cili u informua mbi ecurinë e punimeve dhe mbi rezultatet paraprake të fushatës kërkimore.

Të dhënat e përftuara gjatë fazës së parë të ndërhyrjes në terren dëshmojnë praninë e elementeve me rëndësi shkencore, të cilët kontribuojnë në sqarimin e zhvillimit kronologjik dhe funksional të monumentit në shekujt V-VI e në vijim, si dhe në njohjen e dinamikave socio-ekonomike dhe kulturore të qytetit antik të Scampis.

Në cilësinë e një qendre urbane të rëndësishme përgjatë itinerarit të Via Egnatia, Scampis, objekti i kërkimit paraqet një konfigurim hapësinor që dëshmon funksionin e tij si nyje ndërmjet zonave kulturore të Lindjes dhe Perëndimit. Gërmimet synojnë identifikimin e fazave ndërtimore dhe funksionale të kompleksit monumental, i cili karakterizohet nga një stratigrafi arkitektonike shumëfazore. Vëmendje e veçantë i kushtohet ndërhyrjeve të mëvonshme antropike, përfshirë transformimet dhe rindërtimet e shekullit XX.

**Akademik Gëzim Hoxha, përfaqëson Akademinë e Shkencave të Shqipërisë
në samitin e organizuar me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Parë të
Turkologjisë në Azerbajxhan**



Sot, më 29 qershor 2026, në Baku, kryeqytetin e Azerbajxhanit, nisën punimet e samitit treditor kushtuar 100-vjetorit të Kongresit të Parë të Turkologjisë. Me ftesë të presidentit të Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit akad. Isa Habibbeyli, Akademia e Shkencave e Shqipërisë u përfaqësua nga akad. Gëzim Hoxha kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike.

Ky përfaqësim erdhi pas vizitës së suksesshme dhe nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit midis dy Akademive duke i hapur rrugë bashkëpunimit real si dhe përfaqësim të ndërsjellë në eventet shkencore më të rëndësishme.

Vlen të theksohet se Kongresi i Parë i Turkologjisë u mbajt në Baku nga data 26 shkurt

deri më 6 mars 1926. Rezolutat e miratuara në këtë Kongres mbeten edhe sot tejet aktuale dhe vazhdojnë të kontribuojnë në forcimin e integritit shkencor dhe kulturor të popujve turq.

Në këtë veprimtari marrin pjesë studiues, kërkues dhe shkencëtarë nga vende të ndryshme të botës, të cilët shkëmbejnë përvoja dhe arritje të studimeve të tyre shkencore. Ditën e dytë akad. Gëzim Hoxha do të mbajë fjalën e tij përshëndetëse në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, nderohet me medalje në samitin ndërkombëtar kushtuar 100-vjetorit të Kongresit të Parë të Turkologjisë



Akademia e Shkencave e Shqipërisë u nderua me Medaljen Përkujtimore të 100-vjetorit të Kongresit të Parë të Turkologjisë në Baku, akorduar nga Akademia Kombëtare e Shkencave e Azerbajxhanit, si shenjë vlerësimi për gatishmërinë e shprehur për bashkëpunimin shkencor dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale ndërmjet dy akademive. Në këtë veprimtari, Akademia e Shkencave e Shqipërisë u përfaqësua nga akad. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, me ftesë të presidentit të Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit, akad. Isa Habibbeyli.

Gjatë fjalës së tij në punimet e samitit, akad. Gëzim Hoxha theksoi se përvjetori i 100-të i Kongresit të Parë të Turkologjisë përbën një moment të rëndësishëm për forcimin e dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve akademike. Ai vuri në dukje se marrëdhëniet ndërmjet Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë po hyjnë në një fazë të re përmes nënshkrimit të një memorandumit mirëkuptimi për bashkëpunim shkencor, i cili pritet të hapë mundësi të reja për projekte të përbashkëta kërkimore, shkëmbime akademike dhe bashkëpunim ndërdisiplinor ndërmjet komuniteteve shkencore.

Ai nënvizoi se historia e Shqipërisë, ashtu si ajo e shumë vendeve të përfaqësuara në

samit, dëshmon se qytetërimet zhvillohen përmes dialogut, ndërveprimit dhe shkëmbimit të ideve, e jo në izolim. Në këtë kuadër, trashëgimia kulturore e periudhës osmane përbën një shtresë të rëndësishme të identitetit historik dhe kulturor të vendit.

Duke folur si arkeolog, ai theksoi se studimi i stratifikimit kulturor të Shqipërisë, ku monumentet e periudhës osmane bashkëjetojnë me trashëgiminë ilire, romake, bizantine, mesjetare shqiptare dhe më pas evropiane, e ka forcuar bindjen se trashëgimia kulturore duhet kuptuar si një proces i vazhdueshëm historik, në të cilin çdo periudhë pasuron dhe nuk zvogëlon rëndësinë e atyre që e kanë paraprirë.

Akad. Hoxha u shpreh i bindur se bashkëpunimi ndërmjet dy akademive do të sjellë rezultate të rëndësishme shkencore dhe do të thellojë kuptimin e lidhjeve historike, gjuhësore, arkeologjike dhe kulturore që kanë bashkuar rajonet përkatëse përgjatë shekujve.

Në përmbyllje të samitit, akademiku Gëzim Hoxha u nderua me Medaljen Përkujtimore të 100-vjetorit të Kongresit të Parë të Turkologjisë, akorduar nga Akademia Kombëtare e Shkencave e Azerbajxhanit, në vlerësim të pjesëmarrjes së tij aktive dhe kontributit në këtë veprimtari shkencore.

Institutet dhe komisionet

U zhvillua workshopi "Si zë fill gjuha? Matje në nivel kombëtar e zhvillimit gjuhësor të foshnjave"



Veprimtaria u mbajt sot, më 22 qershor 2026, nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në kuadër të projektit "Gjuha vjen e para - Matja e aftësive gjuhësore në moshat e hershme: identifikimi dhe trajtimi i aftësive ligjërimore për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit".

Prof. dr. Enkeleida Kapia prezantoi rezultatet e para të një studimi që ka bërë me ekipin e saj kërkimor mbi zhvillimin gjuhësor dhe kognitiv të fëmijëve 16–30 muajsh në Shqipëri. Ajo nënvizoi se projekti, i financuar nga AKKSHI në vitin 2024, ka përfshirë mbi 2200 foshnja nga të gjitha qarqet e vendit dhe synon të krijojë instrumentin e parë të standardizuar për matjen e gjuhës shqipe në moshat e hershme.

Në vijim, prof.dr. Kapia foli për rëndësinë strategjike të matjeve të hershme gjuhësore për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, si dhe për uljen e pabarazive sociale. Rezultatet treguan se vajzat shfaqin aftësi gjuhësore më të larta se djemtë, ndërsa niveli arsimor i prindërve nuk ka dalë si faktor përcaktues. Nga ana tjetër, leximi i përbashkët prind-fëmijë u evidentua si një praktikë me ndikim të fortë dhe të qëndrueshëm në zhvillimin gjuhësor.

Duke u ndalur te nevoja për standarde të qarta në vlerësimin e zhvillimit gjuhësor, prof. dr. Kapia ngriti një sërë pyetjesh që hasen shpesh në praktikë: sa fjalë duhet të përdorë tipikisht një fëmijë në një moshë të caktuar, cilat kategori semantike duhet të zotërojë,

çfarë nënkuptohet me ndërthurjen e fjalëve dhe cilat struktura fjalish konsiderohen tipike për faza të ndryshme të zhvillimit.

Prof. dr. Kapia dhe ekipi i saj rekomanduan promovimin e leximit në familje dhe në mjediset parashkollore, mbështetje të veçantë për zhvillimin gjuhësor të djemve, si dhe politika publike konkrete për depistimin e hershëm të aftësive gjuhësore. U theksua gjithashtu nevoja për studime më të detajuara mbi rolin e ekraneve në zhvillimin e fëmijëve.



Në këtë kuadër, ajo theksoi nevojën për një instrument që mund të masë në mënyrë të hershme dhe të saktë zhvillimin gjuhësor të foshnjave, duke përcaktuar kurbat normative të zhvillimit gjuhësor dhe kognitiv.

Workshopi u mbyll me diskutime mbi paketat e politikave publike që synojnë të forcojnë ndërhyrjet e hershme, përfshirë shpërndarjen e librave falas për fëmijët e vegjël, trajnimin e edukatorëve dhe hartimin e udhëzimeve kombëtare për përdorimin e ekraneve.

U mbajt ligjërata “Skena dhe sisteme të ndryshme teatrale – Një analizë krahasuese”, me referuese znj. Abigeila Voshtina



Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua ligjërata magjistrale me temën “Skena dhe sisteme të ndryshme teatrale – Një analizë krahasuese”, e referuar nga violinistja znj. Abigeila Voshtina. Veprimtaria u organizua nga Komisioni i Përhershëm i Arteve pranë Akademisë së Shkencave dhe u moderua nga dr. Denis Bizhga. Në fjalën hapëse, dr. Bizhga theksoi rëndësinë e ciklit të ligjëratave magjistrale, i cili zhvillohet në mënyrë periodike me qëllim promovimin dhe evidentimin e vlerave artistike kombëtare dhe prezantoi më tej profilin e znj. Voshtina, e cila është formuar në Liceun Artistik të Tiranës dhe ka vijuar studimet e mëtejshme në Shqipëri dhe Itali. Ligjërata u mbajt me synimin që ofrojë një analizë krahasuese të menaxhimit dhe interpretimit artistik në institucionet teatrale. Në këtë kontekst, ligjërata u shoqërua me tabela ilustruese mbi burimet e financimit dhe modelet e menaxhimit, duke ofruar një pasqyrë vizuale të qartë mbi dallimet ndërmjet sistemeve teatrale. Znj. Voshtina e vuri theksin në nevojën për forcimin e kapaciteteve menaxheriale dhe përmirësimin e kuadrit ligjor, si dhe për krijimin e strukturave dhe procedurave të qarta për menaxhimin e të dhënave, komunikimin dhe marrëdhëniet institucionale. Nga analiza krahasuese e sistemeve teatrale u evidentua se Italia, megjithëse mbështetet kryesisht në financimin publik, ka nevojë për më shumë autonomi menaxheriale dhe për reforma që nxisin partneritetet publike-private. Shqipëria paraqitet ende me një sistem të centralizuar, të varur nga financimi shtetëror, ku del në pah domosdoshmëria e zhvillimit të kulturës së fundraising-ut, përmirësimit të kuadrit ligjor dhe forcimit të kapaciteteve menaxheriale. Ndërkohë, modeli anglo-sakson i Mbretërisë së bashkuar dhe SHBA-ve u vlerësua si efikas, i bazuar në filantropi dhe fleksibilitet organizativ, por

gjithashtu u theksua rreziku i komercializimit të tepruar, duke e bërë të domosdoshme ruajtjen e ekuilibrit midis logjikës së tregut dhe aksesit të barabartë në kulturë.



Në përmbyllje, zëvendëskryetari i Akademisë, akad. Vasil Tole, e vlerësoi prezantimin si një analizë të qartë dhe të dobishme për kuptimin e kuadrit organizativ, ligjor dhe kulturor të teatrove, duke e cilësuar si një kontribut të rëndësishëm në debatin mbi zhvillimin e politikave kulturore në Shqipëri.

Në mjediset e Muzeut Arkeologjik u zhvillua koncert-konferenca “Nga lira e lashtësisë drejt teatrit lirik” me studiuesin e Akademinë Ndërkombëtare të Lirës dr. Nikos Xanthoulis



Në datën 10 qershor 2026, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Shoqatën e Artistëve të Gjirokastrës “Argjiro” dhe Akademinë Ndërkombëtare të Lirës (ILS Academy) mbajti koncert-konferencën “Nga lira e lashtësisë drejt teatrit lirik”, pjesë e edicionit XVI të ciklit “Takimet Muzikore të Dy Botëve”.

Protagonist i mbrëmjes ishte kompozitori dhe studiuesi i asociuar i Akademisë së Athinës, dr. Nikos Xanthoulis, i cili interpretoi një program të pasur, ku u ndërthurën krijime të autorëve antikë me kompozime moderne të frymëzuara nga tradita klasike. Publiku dëgjoi pjesë të rralla si “Choral”, nga “Orest” i Euripidit (408 p.K.); “Paeani delfik” i Athenaeus (128 p.K.), si dhe “Epitafi i Seikilosit” (shek. II-III e.s.), një nga dëshmitë më të hershme të muzikës së shkruar.

Programi përfshiu gjithashtu krijime të Xanthoulis-it si “Rosa Ritrovata”; “Hear my Prayer” dhe “Honor to Dionysus”, duke u pasuruar me interpretimet e veprave të Handel, Bach, Luiz Bonfá dhe Garry Judd. Kombinimi i muzikës antike me kompozime baroke e moderne krijoi një urë mes kulturave dhe epokave, duke e bërë koncertin një përvojë të rrallë për publikun shqiptar.

Nëpërmjet muzikës, rrëfimit dhe kërkimit shkencor, dr. Xanthoulis solli jo vetëm tingujt e lirës me shtatë tela, por edhe historinë e saj – nga roli në qytetërimin antik deri te ndikimi në traditën e teatrit lirik dhe muzikës së kultivuar europiane.

Ky aktivitet, i organizuar nga Shoqata e Artistëve të Gjirokastrës “Argjiro”, u mirëprit si një ngjarje që ndërthur artin me shkencën, duke i dhënë publikut shqiptar mundësinë të prekë nga afër një pjesë të gjallë të trashëgimisë kulturore universale.



Në fund, drejtuesit e Muzeut Arkeologjik (ASHSH) shprehën falënderimet për dr. Nikolaos Xanthoulis-in për koncertin frymëzues, si dhe për gjithë pjesëmarrësit që ndanë me tyre një mbrëmje, ku muzika u bë urë lidhëse mes së shkuarës dhe së tashmes.

Vizitë zyrtare në Muzeun Arkeologjik të Akademisë së Shkencave: Shqipëria dhe Lituania forcojnë bashkëpunimin



Në ambientet e Muzeut Arkeologjik të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u zhvillua një vizitë institucionale nga bashkëshortja e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, znj. Armanda Begaj, dhe bashkëshortja e Presidentit të Republikës së Lituanisë, znj. Diana Nausėdienė.

Gjatë vizitës, zonjat u njohën me koleksionet e ekspozuara të muzeut, si edhe me fondet arkeologjike të Institutit të Arkeologjisë, të cilat përfaqësojnë një pasuri me vlerë të lartë shkencore dhe kulturore dhe ofrojnë dëshmi të rëndësishme mbi zhvillimin e shoqërive njerëzore në territorin shqiptar gjatë mijëvjeçarëve. Interesi i tyre për materialet arkeologjike, si edhe vlerësimet e shprehura për nivelin e ruajtjes dhe dokumentimit të tyre përbëjnë një vlerësim domethënës për punën e institucionit.

Ato u pritën dhe u shoqëruan nga dr. Melsi Labi dhe znj. Gema Kraja, të cilët prezantuan veprimtarinë muzeale dhe kërkimore të institucionit, si edhe pasuritë arkeologjike që ruhen dhe studiohen në kuadër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Gjatë bashkëbisedimit u diskutuan edhe mundësitë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Lituanisë në fushat e arkeologjisë, muzeologjisë dhe kërkimit shkencor. Në këtë kuadër, u shkëmbyen mendime mbi shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës profesionale, si dhe mbi krijimin e lidhjeve më të ngushta ndërmjet institucioneve kërkimore, muzeale dhe akademike të të dy vendeve. Interesimi i treguar për këto

mundësi bashkëpunimi u vlerësua si një nxitje e rëndësishme për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve kulturore, shkencore dhe akademike ndërmjet Shqipërisë dhe Lituanisë.

Përshtypjet pozitive të tyre, si edhe interesi i tyre për fondet arkeologjike dhe veprimtarinë shkencore të institucionit dëshmojnë rëndësinë e trashëgimisë kulturore shqiptare si një urë komunikimi, dialogu dhe mirëkuptimi ndërmjet popujve. Në përfundim të vizitës, si shenjë mirënjohjeje dhe kujtim i kësaj vizite të veçantë, secilës prej tyre iu dhurua botimi i Institutit të Arkeologjisë “Recent Archaeological Discoveries in Albania”, si edhe disa suvenire me simbole përfaqësuese të trashëgimisë dhe identitetit kulturor shqiptar.



Muzeu Arkeologjik i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë mbetet i përkushtuar në misionin e tij për ruajtjen, studimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, duke e bërë atë pjesë të dialogut kulturor, shkencor dhe akademik kombëtar e ndërkombëtar.

U zhvillua seminari me temën “Sjellja ndaj zjarrit e fasadave të ventiluara: analiza termofluidike e efektit oxhak dhe roli i barrierave”



Më 5 qershor 2026 u zhvillua seminari me temën “Sjellja ndaj zjarrit e fasadave të ventiluara: analiza termofluidike e efektit oxhak dhe roli i barrierave”, i organizuar nga Komisioni i Inxhinierisë dhe Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike. Veprimtaria synoi të evidentojë rëndësinë e studimit të fasadave të ventiluara dhe të rreziqeve që lidhen me përhapjen e zjarrit në këto struktura.

Seminari u moderua nga akad. Jorgo Kaçani, kryetar i Komisionit të Inxhinierisë. Në fjalën e hapjes, ai u shpreh se organizimi i këtij seminari erdhi pas incidentit të zjarrit në fasadën e një ndërtese banimi, me qëllim analizimin e këtij fenomeni, evidentimin e shkaqeve dhe diskutimin e përgjegjësiave të institucioneve dhe aktorëve të përfshirë, duke filluar nga studiot projektuese private dhe kompanitë e ndërtimit. Ai nënvizoi se bëhet fjalë për një problematikë komplekse, që përfshin aspekte të arkitekturës, ventilimit dhe faktorë të tjerë teknikë, të cilët kërkojnë trajtim të kujdesshëm dhe ndërdisiplinor.

Gjithashtu, ai theksoi se seminari synon të ofrojë rekomandime dhe kontribute profesionale e shkencore për institucionet ligjvënëse dhe ligjzbatuese të vendit.

Akad. Kaçani falënderoi të gjithë pjesëmarrësit, veçanërisht kolegët nga Kosova, duke vlerësuar kontributin e Komisionit të Inxhinierisë. Ai theksoi se çështje të tilla lidhen drejtpërdrejt me jetën dhe sigurinë e qytetarëve, ndaj kërkojnë angazhim të përbashkët nga të gjithë aktorët përgjegjës.

Veprimtarinë e përshëndeti kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike, akad. Neki Frashëri, i cili e vlerësoi seminarin si veçanërisht të rëndësishëm, sepse trajton një problematikë me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë e ndërtesave moderne. Ai iu referua rasteve të zjarreve të rënda të regjistruara në Tiranë dhe në qytete të tjera të vendit, si shembuj që nxjerrin në pah nevojën për studime dhe analiza të specializuara në këtë fushë. Më tej, ai trajtoi faktorët kryesorë që ndikojnë në përhapjen e zjarrit dhe rolin e barrierave mbrojtëse në kufizimin e tij.



Në përmbyllje, akad. Frashëri vuri theksin te ndërgjegjësimi dhe përgatitja e profesionistëve të fushës së inxhinierisë dhe arkitekturës për sfidat që lidhen me sigurinë e ndërtesave në kushtet e zhvillimeve urbane bashkëkohore. Ai vlerësoi gjithashtu kontributin e Akademisë së Shkencave në promovimin e zbatimit të standardeve, rregullave dhe protokolleve në fushën e inxhinierisë.

Veprimtarinë e përshëndetën gjithashtu përfaqësues të universiteteve dhe institucioneve, ndër të cilët prof. dr. Mirlind Bruci, dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës; prof. dr. Violeta Nushi, dekane e Fakultetit të Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës; znj. Valbona Dushi, udhëheqëse e Departamentit të Industrisë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit të Kosovës, si dhe përfaqësues nga Bashkia e Tiranës.

Sesioni i parë iu kushtua studimeve mbi fasadat e ventiluara dhe sjelljen e tyre ndaj zjarrit. Dr. Ramadan Alushaj, nga Universiteti Politeknik i Tiranës, prezantoi analizën termofluidike të efektit oxhak dhe rolin e barrierave mbrojtëse, ndërsa znj. Irida Branko dhe znj. Ani Tola, po nga i njëjti universitet, paraqitën një studim arkitektonik mbi ndërtesat me fasada të ventiluara dhe zgjidhjet e propozuara për parandalimin e përhapjes së zjarrit.

Pas prezantimeve, pjesëmarrësit zhvilluan diskutime të gjera mbi sfidat teknike dhe arkitektonike që lidhen me këto sisteme fasadash, duke nënvizuar rëndësinë e përditësimit të standardeve të sigurisë për ndërtesat moderne.

U mbajt ligjërata me temën: "Aplikime të fonetikës akustike në studimet dialektologjike" nga prof. Luciano Romito



Sot, më 5 qershor 2026 është zhvilluar ligjërata "Aplikime të fonetikës akustike në studimet dialektologjike" nga prof. Luciano Romito (profesor dhe drejtor i Laboratorit të Fonetikës, në Universitetin e Kalabrisë), organizuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në fjalën hapëse dr. Valbona Sinanaj theksoi, se ndërthurja midis oralitetit dhe shkrimit vazhdon të tërheqë vëmendjen dhe të bashkojë studiues nga fusha të ndryshme disiplinore. Marrëdhënia që ekziston midis oralitetit dhe shkrimit trajtohet përmes qasjes multidisiplinare, si: transkriptimi forensik, dialektologjik, të analizës së diskursit, të përkthimit dhe në kontekste dygjuhëshe dhe shumëgjuhëshe.

Në prezantimin e tij prof. Luciano Romito trajtoi rolin thelbësor të fonetikës akustike në studimet bashkëkohore dialektologjike. Tradicionalisht, dokumentimi i dialekteve mbështetej në transkriptime impresioniste dhe atlase në format letre, mjete që në mënyrë të pashmangshme sillnin ndryshime subjektive dhe humbje të informacionit. Sot, përkundrazi, analiza akustike mundëson matjen e parametrave, si frekuenca themelore, formantet, kohëzgjatja dhe intensiteti, duke ofruar të dhëna të riprodhueshme dhe të krahasueshme.

Kjo qasje nuk e zëvendëson dialektologjinë tradicionale, por e fuqizon atë, duke integruar perceptimin, artikulimin dhe sociolinguistikën. Mbledhja e të dhënave akustike e shndërron të folurin në një të dhënë shkencore, duke e çliruar atë nga filtri i studiuesit që e mbledh, dhe duke e bërë të ripërdorshme në studimet krahasuese.

Teknika të tilla, si elektropalatografia, elektroglotografia dhe analizat spektrografike,

mundësojnë vëzhgimin me saktësi të lartë të fenomeneve artikulatore dhe fonologjike. Fonetika akustike përfaqëson një urë lidhëse midis asaj që folësi prodhon dhe asaj që dëgjuesi percepton, duke ofruar në çelës objektiv për të kuptuar variacionin dialektor. Ligjërata u ndoq me interes dhe pati diskutime e mjaft pyetje interesante nga të pranishmit.



U zhvillua mbledhja e Komisionit të Përhershëm të Shkencave Mjekësore



U zhvillua mbledhja e radhës e Komisionit të Përhershëm të Shkencave Mjekësore, e cila u drejtua nga kryetari i komisionit, akad. Genc Sulçebe. Në hapje të mbledhjes, ai u uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe theksoi rëndësinë e temës së trajtuar, duke vënë në dukje ndikimin e saj në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe praktikës klinike në vend.

Mbledhja wshtw zhvilluar me datw 9 qershor 2026, tema kryesore e mbledhjes u prezantua nga prof. asoc. Arbi Pecani, i cili paraqiti projektin kërkimor mbi përcaktimin e markuesve laboratorikë dhe gjenetikë specifikë për sëmundjet autoimune me prekje pulmonare në Shqipëri. Në fjalën e tij, ai theksoi se reumatologjia është një nga fushat e mjekësisë që ka njohur zhvillime të rëndësishme shkencore në vitet e fundit, falë përparimeve në biologjinë molekulare, imunologji dhe gjenetikë, të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm diagnostikimin, trajtimin dhe monitorimin e sëmundjeve autoimune dhe inflamatore.

Prof. asoc. Pecani nënvizoi se projekti synon identifikimin e markuesve laboratorikë dhe gjenetikë me vlerë diagnostike për pacientët me sëmundje autoimune dhe prekje pulmonare, duke aplikuar për herë të parë në Shqipëri teknologji bashkëkohore në këtë

fushë. Ai prezantoi objektivat kryesore të projektit, të cilat përfshijnë hartimin e protokollit të punës me mjekë specialistë, përzgjedhjen e markuesve sipas standardeve ndërkombëtare dhe vlerësimin e kontributit të tyre në diagnostikimin e hershëm dhe trajtimin e personalizuar të pacientëve. Ndër rezultatet e pritshme u përmendën aplikimi i metodave të reja laboratorike dhe gjenetike në vend, identifikimi i vlerës së tyre diagnostike dhe përmirësimi i cilësisë së trajtimit dhe jetës së pacientëve.

Gjatë diskutimeve, akad. Genc Sulçebe vlerësoi rëndësinë shkencore të projektit, duke theksuar se zhvillimet e fundit në përdorimin e antitropave monoklonalë dhe terapive me qeliza të modifikuara po transformojnë trajtimin e sëmundjeve autoimmune. Ai evidentoi gjithashtu sfidat që lidhen me rekrutimin e pacientëve dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërdisiplinor, veçanërisht me radiologët, si edhe studimin e lidhjeve me alelet HLA në vlerësimin e këtyre patologjive.

Prof. Gjeorgjina Kuli-Lito ngriti çështjen e përdorimit të indekseve prognostike, përtej prekjes pulmonare, ndërsa prof. asoc. Arbi Pecani theksoi se studimi i markuesve të rinj gjenetikë dhe aleleve HLA synon të krijojë bazat për zhvillimin e mjekësisë së personalizuar në popullatën shqiptare.

Workshop për përforcimin e bashkëpunimit shkencor dhe funksionalizimin e grupeve të punës të Njesisë "Pasuritë Ujore"



Më 26 qershor 2026, në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, u zhvillua workshop-i me temë "Përforcimi i bashkëpunimit shkencor dhe funksionalizimi i grupeve të punës të Njesisë 'Pasuritë Ujore'".

Aktiviteti mbledhi ekspertë, studiues dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme, të cilët ndanë ekspertizat, përvojat dhe idetë e tyre mbi prioritetet shkencore dhe drejtimet e ardhshme të bashkëpunimit në fushën e pasurive ujore.

Një nga momentet më të rëndësishme të workshop-it ishte organizimi dhe formalizimi i grupeve tematike të punës, të cilat do të fokusohen në tre drejtime kryesore: menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave mjedisore, menaxhimin e ujit për konsumatorin dhe menaxhimin e ujërave në kuadër të ekonomisë qarkulluese. Këto grupe synojnë të forcojnë koordinimin ndërmjet ekspertëve dhe të nxisin zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore.

Workshop-i përbën një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të bashkëpunimit ndër-institucional dhe krijimit të një platforme të qëndrueshme për zhvillimin e kërkimit shkencor, shkëmbimin e njohurive dhe adresimin e sfidave në menaxhimin e pasurive ujore.

Botime të reja

Botimet më të reja të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



-Ditari i tranzicionit ekonomik: Shqipëria më afër Bashkimit Europian – Shpërblimi i reformave, libër nga akad. Anastas Angjeli

Ky vëllim i ri, pjesë e kolanës “Ditari i tranzicionit ekonomik”, sjell një pasqyrë të gjerë të zhvillimeve ekonomike dhe sociale të Shqipërisë, me fokus të veçantë periudhën e tranzicionit dhe rrugëtimin e vendit drejt Bashkimit Europian.

Përmes shënimeve, diskutimeve dhe analizave të autorit, vepra dokumenton reformat, sfidat dhe arritjet e 30 viteve të fundit, duke lënë një dëshmi historike dhe shkencore mbi transformimin ekonomik të Shqipërisë.

Viti: 2025

Faqe: 679

ISBN (Kolana): 9789928309471

ISBN (Libri 12): 9789928855244

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

Promovohet libri i prof. asoc. dr. Ethem Çekut: “Lëvizja shqiptare për pavarësi: Politika, kryengritjet dhe diplomacia, 1908–1912”



Instituti i Historisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizoi promovimin e veprës më të re të prof. asoc. dr. Ethem Çekut, “Lëvizja shqiptare për pavarësi: Politika, kryengritjet dhe diplomacia, 1908–1912”.

Veprimtaria u moderua nga drejtori i Institutit të Historisë, akad. Hamit Kaba, i cili nënvizoi se studimi është një shembull i kërkimit serioz shkencor.

Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, përshëndeti kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, akad. Gëzim Hoxha. Ai e cilësoi librin e prof. asoc. Ethem Çekut si një kontribut të veçantë për historiografinë shqiptare. Vlera e veçantë e veprës qëndron në trajtimin e nacionalizmit shqiptar jo thjesht si një ide abstrakte, por si një proces të gjallë politik, kulturor dhe diplomatik, që u shfaq në mënyrë të plotë gjatë viteve 1908–1912.

Akad. Hoxha theksoi se libri pasuron debatin akademik me interpretime të reja, duke u dhënë vendin e merituar ngjarjeve të kësaj periudhe në historiografinë kombëtare, dhe shërben si një referencë e domosdoshme për studiuesit e historisë shqiptare, me një jehonë që meriton të shtrihet edhe në gjuhë të huaja.

Në vijim të veprimtarisë promovuese, akad. Pëllumb Xhufi e vlerësoi monografinë e prof. asoc. dr. Ethem Çekut për sintetizimin e plotë të procesit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në vitet 1908–1912. Sipas tij, autori ka kapërcyer trajtimet e fragmentuara të mëparshme,

duke e paraqitur këtë periudhë si një tërësi politike, kulturore, ideologjike dhe diplomatike, ku kryengritjet, figurat dhe idetë kombëtare ndërthuren në një proces që kulmoi me shpalljen e Pavarësisë.

Sipas tij, autori i ka vendosur kryengritjet e viteve 1909–1912 në kontekstin e gjerë ballkanik dhe europian, si dhe ka trajtuar me objektivitet figurat kryesore të kohës: nga Ismail Qemali e Isa Boletini te Mithat Frashëri e Bajram Curri, duke i paraqitur me kontradiktat e tyre të brendshme, larg mitologjizimit tradicional.

Ai u shpreh se monografia e Çekut është një arritje e rëndësishme për historiografinë shqiptare, sepse jo vetëm dokumenton faktet, por edhe i vendos ato në një kuadër analitik e konceptual, duke e parë pavarësinë e vitit 1912 si rezultat të një procesi kompleks e kontradiktor, të ndikuar nga faktorë të brendshëm dhe ndërkombëtarë.

Akad. Muhamet Mala u shpreh se libri i prof. asoc. Çekut, “Lëvizja shqiptare për pavarësi: Politika, kryengritjet dhe diplomacia, 1908–1912”, është një studim i thelluar kritik e shkencor, që i jep vendin e merituar ngjarjeve të viteve 1908–1912 në historinë shqiptare. Autori ka arritur të paraqesë me qartësi kontinuitetin e lëvizjes shqiptare, duke e lidhur politikën, kryengritjet dhe diplomacinë në një proces të pandarë që kulmoi me shpalljen e Pavarësisë.



Vepra nuk është thjesht një përshkrim kronologjik i ngjarjeve, por një analizë e gjerë kulturore dhe politike, ku trajtohen Kongresi i Manastirit, alfabeti si kufi kulturor e politik, kryengritjet shqiptare dhe roli i figurave si Ismail Qemali, theksoi akad. Mala. Ai vlerësoi gjithashtu kontributin që sjell libri si referencë e rëndësishme për studiuesit e historisë shqiptare dhe ballkanike.

Gjithashtu, akad. Hamit Kaba e cilësoi veprën e prof. asoc. Ethem Çekut si një monografi

të mirëstrukturuar dhe të konceptuar me kujdes, që sjell një qasje kritike ndaj procesit të shtetformimit shqiptar. Sipas tij, periudha e viteve 1908–1912 nuk duhet parë si një përmbyllje e natyrshme e Rilindjes Kombëtare, por si një moment krize të shumëfishtë: të Perandorisë Osmane, të ekuilibrave ballkanikë e europianë, si dhe të elitës politike shqiptare.

Ai theksoi se autori ka arritur të çlirohet nga emocionet patriotike dhe nga tradita viktimizuese, duke analizuar me objektivitet vonesat dhe dilemat e elitës shqiptare në procesin e shkëputjes nga Perandoria Osmane. Libri sjell një trajtim të qartë të kalimit të Rilindjes Kombëtare nga projekti autonomist drejt projektit të pavarësisë, duke e mbështetur këtë analizë në një bazë të gjerë dokumentare dhe në një metodologji shkencore.

Në mbyllje të ligjëratave, prof. asoc. dr. Ethem Çeku falënderoi Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për mbështetjen institucionale dhe recensentët për vlerësimet e tyre shkencore. Ai theksoi se periudha 1908–1912 përbën etapën vendimtare të formimit të shtetit shqiptar, kur, përmes kryengritjeve, organizimit politik dhe forcimit të ndërgjegjes kombëtare, shqiptarët realizuan përpjekjen më të rëndësishme për çlirimin dhe shtetformimin e tyre.

Libri mbështetet në një metodologji të integruar kërkimore, që ndërthur analizën historike me vlerësimin kritik të dokumentacionit dhe qasjen ndërdisiplinore. Ai mbështetet në burime arkivore dhe bibliografi në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, duke ofruar një rishqyrtim të nacionalizmit, shtetformimit dhe transformimeve politike e shoqërore të Perandorisë Osmane në fazën e saj përfundimtare.

Sipas Çekut, vepra mbështetet në burime të verifikueshme dhe në një qasje kritike që ndihmon në kuptimin më të plotë të procesit të pavarësisë dhe të shtetformimit shqiptar. Në mbyllje të veprimtarisë, të pranishmit shprehën vlerësimet dhe mirënjohjen ndaj autorit për studimin e thelluar të një periudhe me rëndësi të veçantë në historinë e shqiptarëve, e cila i parapriu shpalljes së Pavarësisë.

“Paradigma në grupe emërore” nga akad. Ethem Lika



Ky është një nga botimet më të fundit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Kjo vepër paraqet një studim origjinal dhe kompleks mbi paradigmen e sistemit emëror të gjuhës shqipe. Me një qasje të gjerë shkencore, autori nuk kufizohet vetëm në paradigmen e fjalëve emërore të veçanta, por analizon dhe shpjegon nga pikëpamja morfologjike dhe sintaksore grupet emërore në rrafsh bashkëkohor dhe historik.

Studimi trajton grupet emërore me dy dhe, më rrallë, me tre përbërës, duke vënë në pah jo vetëm paradigmen e fjalës, por edhe paradigmen e grupit të fjalëve dhe lidhjet sintaksore brenda tij. Botimi përbën një kontribut me vlerë në fushën e gjuhësisë së sotme dhe të gjuhësisë historike shqiptare.

Viti: 2025


Faqe: 194

ISBN: 9789928855282

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

Botohet nga Akademia e Shkencave “Pjetër Budi, Vepra III: Rituali roman (1621)”, përgatitur nga prof. Bardhyl Demiraj



-Ditari i tranzicionit ekonomik: Shqipëria më afër Bashkimit Europian – Shpërblimi i reformave, libër nga akad. Anastas Angjeli

Ky vëllim i ri, pjesë e kolanës “Ditari i tranzicionit ekonomik”, sjell një pasqyrë të gjerë të zhvillimeve ekonomike dhe sociale të Shqipërisë, me fokus të veçantë periudhën e tranzicionit dhe rrugëtimin e vendit drejt Bashkimit Europian.

Përmes shënimeve, diskutimeve dhe analizave të autorit, vepra dokumenton reformat, sfidat dhe arritjet e 30 viteve të fundit, duke lënë një dëshmi historike dhe shkencore mbi transformimin ekonomik të Shqipërisë.

Viti: 2025

Faqe: 679


ISBN (Kolana): 9789928309471

ISBN (Libri 12): 9789928855244

Për të parë botimet e reja nga Akademia e Shkencave klikoni linkun:

<https://akad.gov.al/veprat-e-botuara-nga-ashsh/>

Botimi i ri shkencor i akad. Albert Doja në fushën e antropologjisë së fesë



Është botuar së fundmi vepra më e re shkencore e akademikut Albert Doja, “On Agamben, and Acts of Faith, under Oath: Meaning Transformations in Language, Morality, and Religion”, pranë shtëpisë botuese ndërkombëtare "Springer Nature". Kjo vepër përbën një kontribut të rëndësishëm teorik dhe metodologjik në fushën e antropologjisë së fesë dhe të studimeve mbi sistemet simbolike.

Në këtë studim, autori ndërmerr një analizë kritike të qasjeve bashkëkohore mbi gjuhën dhe religjionin, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në problematikat teorike të ngritura nga Giorgio Agamben mbi rolin e betimit dhe të përvojës së gjuhës në themelimin e institucioneve shoqërore. Përmes një rishqyrtimi të argumentuar, vepra propozon një rikonceptualizim të marrëdhënieve ndërmjet gjuhës, fesë, moralit dhe politikës, në kuadër të një perspektive analitike të integruar.

Qasja metodologjike e ndjekur është ndërdisiplinore, duke ndërthurur analiza antropologjike, gjuhësore dhe filozofike, me synimin për të evidentuar mekanizmat përmes të cilëve ndërtohen dhe transformohen strukturat e kuptimit dhe normat

shoqërore. Në këtë kuadër, një vend të veçantë zë shqyrtimi i traditës shqiptare, ku trajtohen kategori themelore si besimi, betimi dhe “besa”, si elemente të ndërthurura të rendit moral, juridik dhe shoqëror.

Duke u mbështetur në analizën strukturore dhe në teorinë e akteve të të folurit, studimi shqyrton evolucionin e sistemeve fetare si procese të transformueshme, në të cilat ndërveprojnë forma të ndryshme të organizimit teologjik, institucional dhe politik. Në përfundim, kjo vepër ofron një kornizë analitike të avancuar për studimin e fesë si fenomen shoqëror kompleks dhe dinamik.

Për më shumë, shikoni linkun më poshtë:

<https://www.awin1.com/cread.php?awinmid=26429...>

U prezantua libri “Don Gjon Buzuku dhe ‘Meshari’ i tij” i autorit Bardhyl Demiraj



Veprimtaria u mbajt sot, më 4 qershor 2026, e organizuar nga Komisioni i Përhershëm i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Prezantimi i librit kishte për synim të rikthente në qendër të vëmendjes rëndësinë e ‘Mesharit’ si monumenti më i hershëm i gjuhës shqipe dhe kontributin e autorit Bardhyl Demiraj, i cili me këtë botim sjell një analizë të thelluar mbi figurën e Don Gjon Buzukut dhe trashëgiminë e tij letrare, themelore për gjuhën e kulturën tonë.

Në fjalën hapëse, prof. dr. Anila Omari, Kryetare e Komisionit të përhershëm të gjuhësisë dhe të letërsisë, theksoi se studimet albanologjike dhe veçanërisht ato buzukiane pasurohen me monografinë e re të prof. Bardhyl Demirajt.

Kjo vepër ndriçon aspekte të pasqaruara ose të patrajtuara më parë të librit të parë shqip, ‘Mesharit’ të Gjon Buzukut. Shumë çështje enigmatike që shtrën përpara studiuesve libri i Buzukut, në monografi përballohen me sukses dhe analizohen me argumente plotësuese dhe me përfundime novatore.

Prof. dr. Evalda Paci, drejtuese e Departamentit të Studimeve Letrare, paraqiti një vështrim të saj mbi vëllimin studimor “Don Gjon Buzuku dhe ‘Meshari’ i tij” (Botime Françeskane, Shkodër, 2026). Ajo e introduktoi atë si fryt të një pune shumëvjeçare, me rezultate konkrete dhe të prekshme në një numër të konsiderueshëm kontributesh shkencore, të lidhura ngushtë me një tematikë aktuale në historinë e studimeve filologjike shqiptare. Sipas saj, libri përbën një shtysë të re për t’i kushtuar vëmendjen e merituar ekzemplarit të përmendur, duke trajtuar një sërë çështjesh filologjike e përmbajtësore që

çojnë drejt thellimit të studimeve.

Në trajtesën e prof. dr. Pacit u reflektua dhe ndarja në kapituj e këtij vëllimi, në të cilët trajtohen çështje si: “Libri dhe autori”, të dhënat biobibliografike dhe tipografike, përshkrimi fizik e topografik, kolofoni si peritekst, rrethanat dhe synimet e autorit, historiku i përdorimit të veprës; konsultimi më i hershëm i saj (1743); struktura dhe organizimi i tekstit, me disa nënkrerë të përqendruar në trajtimin e Offices, Psalmeve të pendesës, dekalogun (decem praecepta Dei); Mbi shtatë veprat e mëshirës (De septem operibus misericordiae); sakramendet; foliet/fletët që mungojnë etj.

Çështje të përkimeve tekstore, të elementeve të munguara në vështrim përqasës me të tjera modele burimore paraqiten të trajtuara hollësisht në vëllimin studimor të profesor Demirajt, duke përfaqësuar dhe një vijimësi të qartë metodologjike në krejt shtrirjen e tij. Një qasje me rëndësi ishte edhe prezantimi i prof. dr. Anila Omarit, e cila u ndal te çështja e formimit teologjik-intelektual të Buzukut dhe te tekstet burimore që autori i monografisë ka identifikuar si modele mundshme të ‘Mesharit’. Ajo theksoi se hipoteza e aktivitetit të Buzukut në rajonin e Venecies si famullitar i Kishës së Shën Jobit është një mbështetje e rëndësishme për të kuptuar burimet dhe modelet që ai ka ndjekur në hartimin e veprës.



Prof. dr. Omari vuri në dukje se studimi i Demirajt, i mbështetur në një metodë solide e me kriterë të përcaktuara qartë, sjell prova të reja mbi ndikimet e përkthimeve biblike të humanistëve të mëdhenj të kohës, si Erasmi i Roterdamit dhe veneciani Antonio Brucioli, në tekstin e 'Mesharit'. Krahasimi i pjesëve të tekstit të Buzukut me verset e Vulgatës latine dhe me përkthimet humaniste dëshmon përkime të shumta me këto tekste dhe mbështet idenë e autorit që Buzuku u ndikua nga fryma e humanizmit kristian të kohës dhe vendit ku ai veproi, duke e pozicionuar Buzukun në rrethin e intelektualëve humanistë të diasporës shqiptare të shekujve XV-XVI si Marin Barleti, Marin Beçikemi, Gjon Gazulli, Dhimitër Frangu etj.



Nga kjo perspektivë autori ka kërkuar me një punë intensive e ngulmuese edhe modelet burimore ku mund të jetë mbështetur Buzuku për hartimin e veprës së tij dhe, duke zbatuar të njëjtën metodë krahasuese ndërtekstuale, arrin të veçojë si tekstin më të mundshëm burimor të 'Mesharit' një leksionar latinisht-italisht anonim botuar në Venecie në vitin 1551, shumë të ngjashëm me tekstet e Antonio Bruciolit, me të cilin teksti i Buzukut dëshmon bashkëpërkime tepër të dukshme që arrijnë deri 100% në pjesën e dytë të 'Mesharit' dhe përfshijnë deri edhe gabimet e shtypit e lajthitjet në radhitje e pagjinim.

Prof. Omari përfundoi fjalën e saj duke theksuar se monografia shënon një etapë të re në studimet buzukiane dhe njëkohësisht hap rrugën për hulumtime të mëtejshme sipas një metode filologjike të përvijuar saktë e tashmë të sprovuar me rezultate konkrete. Autori është treguar i kujdesshëm për të qenë sa më transparent në hapat dhe proceset në të cilat ka kaluar studimi i tij dhe sa më i rezervuar në shpalljen e risive të veprës së tij, duke lënë çelur shtigjet e duke shënuar edhe drejtimet e kërkimit në të ardhmen qoftë edhe nga studiues të tjerë.

Podcast Akademia

Podcast AKADEMIA 1: Intervistë me akademik Arben Merkoçi



Fillon episodi i parë i “Podcast Akademia”, një hapësirë e dedikuar dialogut mbi shkencën, dijen dhe zhvillimin akademik në vend. Ky podcast synon të krijojë një urë komunikimi midis institucioneve akademike dhe publikut, duke sjellë diskutime të hapura, të thelluara dhe me vlerë.

Në episodin e parë të “Podcast Akademia”, akad. Arben Merkoçi prezanton rrugëtimin e krijimit të NanoAlb-it, njësisë së parë të specializuar në nanoteknologji pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Ai ndan vizionin, objektivat dhe perspektivat e kësaj nisme, duke theksuar rolin e saj në zhvillimin e kërkimit shkencor, inovacionit teknologjik dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Për ta ndjekur të plotë, skanoni kodin QR:



Podcast AKADEMIA 2: Intervistë me z. Andreas Dushi, drejtor i QBAE



Në episodin e dytë të podcastit “Akademia”, z. Andreas Dushi, drejtor i Qendrës së Botimeve Albanologjike dhe Enciklopedike, sjell në fokus tri nga projektet më të rëndësishme të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në fushën e albanologjisë dhe cili është roli i këtyre veprave në zhvillimin dhe pasurimin e dijes shkencore shqiptare.

Për ta ndjekur të plotë, skanoni kodin QR:



Të tjera

Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron akademikët dhe studiuesit në ditët e lindjes

Akademia e Shkencave e Shqipërisë shpreh vlerësimin e saj institucional për akademikët dhe studiuesit, veprimtaria shkencore e të cilëve përfaqëson kontribute të konsoliduara dhe me ndikim në zhvillimin e mendimit akademik shqiptar në fusha të ndryshme të dijes.

Me rastin e 101-vjetorit të lindjes, Akademia përçjell vlerësim të veçantë për akademikun Luan Omari, figurë e shquar e shkencës juridike shqiptare, autor dhe studiues me kontribute themelore në zhvillimin e së drejtës publike, në studimet kushtetuese dhe në konsolidimin e doktrinë juridike në Shqipëri.

Me rastin e ditëlindjes, përcillen vlerësime për akademikun Ilia Mikerezi dhe akademikun dhe albanologun arbëresh Matteo Mandalà, në shenjë vlerësimi për kontributet e tyre në fushën e studimeve akademike dhe albanologjike.

Gjithashtu, Akademia përçjell vlerësime për prof. dr. Emil Lafe, për kontributin e tij të spikatur në gjuhësinë shqiptare dhe në studimet gjuhësore historike, si dhe për akademikun Mehmet Kraja, për veprimtarinë e tij në fushën e letërsisë dhe të mendimit kritik bashkëkohor.

Po ashtu, vlerësohet kontributi i akademikut Arben Merkoçi në kërkimin shkencor bashkëkohor dhe në përfaqësimin e tij në arenën ndërkombëtare, veçanërisht në fushat e nanoshkencave dhe bioshkencave.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë rithekson vlerësimin për veprën dhe kontributet e tyre shkencore, të cilat mbeten pjesë e rëndësishme e zhvillimit të dijes dhe kulturës akademike në vend.

Certifikimi i “Mbledhësve të traditës”, mirënjohje për ruajtësit e kujtesës shqiptare



Në kuadër të konferencës shkencore ndërkombëtare “Kur toka flet me emra” – Hapësira si kujtesë, një moment kyç për shkencën e hapur ishte certifikimi i 70 mbledhësve të parë që kanë kontribuar në lëndën e parë të projektit “Thirre vendin tënd”.

Në shenjë vlerësimi për kontributin e tyre në ruajtjen e trashëgimisë kulturore, tre certifikatat e para simbolike u dorëzuan personalisht nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Sh.T.Z. Bajram Begaj, dhe Kryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi.

Të gjithë kontribuesit e tjerë u vlerësuan me certifikatën “Mbledhës Tradite”.

Projekti “Thirre vendin tënd” është shtrirë në të gjithë hapësirën shqipfolëse përmes një rrjeti mësuesish, nxënësish dhe mbledhësish vendorë, duke u shndërruar në një model të suksesshëm të ndërthurjes së kërkimit shkencor me shoqërinë.

Përmes kësaj nisme, toponimet nuk trajtohen thjesht si një listë emërtesash, por si mbartëse të vijueshme të kujtesës sonë gjuhësore, historike e antropologjike.

Me këtë nismë, rikthehet tradita e mbledhësve të folklorit përmes certifikimit të 70 mbledhësve të parë.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare organizuan ligjëratën “Meshari i (pa)njohur” nga prof. dr. Vehbi Miftari



Sot më 9 qershor 2026, në Akademinë Shkencave të Shqipërisë në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, u mbajt një ligjëratë e veçantë nga prof. dr. Vehbi Miftari lidhur me historinë e zbulimit, studimit dhe ruajtjes së ekzemplarit të vetëm të njohur deri më sot të “Mesharit” të Gjon Buzukut dhe vlerat e tij për historinë e gjuhës shqipe, kulturën e shkruar dhe identitetin kombëtar.

Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, pjesëmarrësit i përshëndeti zëvendëskryetari akad. Vasil Tole, i cili vlerësoi rëndësinë e veçantë të “Mesharit” në traditën e studimeve albanologjike dhe kontributin e vazhdueshëm të kërkimit shkencor për ndriçimin e aspekteve të reja të kësaj vepre themelore. Duke vlerësuar librin më të fundit të prof. dr. Vehbi Miftarit, “Meshari i (pa)njohur”, akad Tole shpjegoi se, sipas profesorëve të gjuhësisë, “Meshari” mbetet një nga veprat më të studiuar që nga themeluesit e gjuhësisë shqiptare e deri në ditët tona.

Megjithatë, akad. Tole nënvizoi se Akademia e Shkencave e çmon faktin që për vepra themelore si “Meshari” vazhdon të shkruhet dhe të studiohet. Gjithashtu, ai vlerësoi bashkëpunimin me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe paraqiti shkurtimisht disa prej projekteve kryesore shkencore në zhvillim në Akademinë e Shkencave, siç është

"Enciklopedia shqiptare", "Historia e shqiptarëve" dhe "Fjalori i madh i gjuhës shqipe", i cili tashmë është online.

Drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, znj. Majlinda Toçi, në fjalën e saj përshëndetëse theksoi se "Meshari" i Gjon Buzukut përbën një nga monumentet më të rëndësishme të kulturës dhe identitetit shqiptar, duke vijuar të mbetet objekt i rëndësishëm i kërkimit shkencor. Ajo vlerësoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në ruajtjen, studimin dhe promovimin e trashëgimisë së shkruar, si dhe vuri në dukje se Biblioteka Apostolike e Vatikanit kishte përcjellë një mesazh përshëndetës me rastin e kësaj veprimtarie.



Fillimisht prof. dr. Vehbi Miftari falënderoi Akademinë e Shkencave për organizimin dhe mbështetjen e veprimtarisë, duke e cilësuar “Mesharin” si një monument kulture, që mbetet themel i identitetit gjuhësor dhe kulturor të shqiptarëve. Më tej ai u shpreh se për të është një nder i veçantë dhe një kënaqësi e madhe që të kontribuojë qoftë edhe në mënyrë modeste, në avancimin e studimeve albanologjike, veçanërisht të atyre që lidhen me këtë vepër monumentale të gjuhës shqipe.



Në ligjëratën e tij, prof. dr. Vehbi Miftari prezantoi rezultatet e studimit të parë tipografik mbi ekzemplarun unik të “Mesharit” të Gjon Buzukut, të ruajtur në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit, realizuar gjatë viteve 2024–2026, duke përcaktuar shkronjat, të cilat dëshmojnë përdorimin e një alfabeti origjinal dhe pajisjeve grafike të kohës, nëpërmjet të cilave hidhet dritë më e qartë mbi bazat tipografike të librit të parë shqip të botuar në vitin 1555; si dhe teknikën e shtypshkrimit, ku analiza më të hollësishme ofrojnë detaje shkencore mbi kaligrafinë e përshtatur për shtyp, llojin e shkronjave (tipat latine gjysmë-gotike) dhe mënyrën e kompozimit të faqeve nga punishtet e shekullit të 16-të. Me rastin e kësaj veprimtarie, Biblioteka Kombëtare ekspozoi për publikun edhe kopjen e “Mesharit”, dhuratë e Papa Françeskut I, me synimin që t’u ofrojë të pranishmëve mundësinë për t’u njohur nga afër me këtë dëshmi të rrallë të kulturës së shkruar shqiptare.

Forcimi i bashkëpunimit shkencor rajonal në hortikulturë: përvoja dhe perspektivat e Grupit të Punës të ISHS nën udhëheqjen e akad. Nazim Gruda



Shoqata Ndërkombëtare e Shkencës së Hortikulturës (International Society for Horticultural Science - ISHS) ka publikuar në faqen e saj zyrtare një përmbledhje mbi aktivitetet e Grupit të Punës për Perimet dhe Pataten në Evropën Juglindore dhe Lindore. Gjatë periudhës 2017–2026, nën drejtimin e suksesshëm të akad. Nazim Gruda, Grupi i Punës ka ruajtur vazhdimësinë dhe dukshmërinë e tij brenda komunitetit shkencor të ISHS dhe në fushën e hortikulturës në përgjithësi, duke kontribuar në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kërkimore dhe universitare në Evropën Juglindore dhe më gjerë. Gjithashtu janë organizuar disa simpoziume rajonale dhe është konsoliduar një platformë e qëndrueshme për shkëmbim shkencor dhe profesional. Një moment i rëndësishëm i kësaj periudhe përbën organizimi i një sërë simpoziumesh rajonale, përfshirë Simpoziumin VII në Maribor (2017), Simpoziumin VIII në Ohër (2021, i zhvilluar online për shkak të pandemisë COVID-19), Simpoziumin IX në Bukuresht (2023) dhe Simpoziumin X në Chania (2026). Këto veprimtari kanë kontribuar në shkëmbimin e rezultateve shkencore dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Simpoziumi i ardhshëm do të mbahet në Kaunas, Lituani në vitin 2029, i organizuar nga Qendra Lituanëze për Kërkime në Bujqësi dhe Pylltari (LAMMC), ndërsa është propozuar që edicioni pasues të zhvillohet në Turqi në vitin 2032.

27 vjet nga hyrja e trupave të NATO-s në Kosovë



Më 12 qershor 1999, trupat e NATO-s hynë në Kosovë në kuadër të misionit paqeruajtës KFOR, duke shënuar përfundimin e konfliktit të armatosur ndërmjet forcave shqiptare të organizuara në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe forcave ushtarake e policore të Republikës Federale të Jugosllavisë.

Për një pjesë të madhe të popullsisë së Kosovës, 12 qershori konsiderohet si dita e çlirimit dhe si një nga datat më të rëndësishme në historinë bashkëkohore të vendit. Ndonëse nuk njihet si festë zyrtare, kjo datë mbetet e rëndësishme edhe në historinë diplomatike dhe ushtarake ndërkombëtare, për shkak të tensioneve që u shfaqën ndërmjet NATO-s dhe Rusisë gjatë vendosjes së forcave paqeruajtëse në Kosovë.

Njësitë e para të NATO-s që hynë në Kosovë më 12 qershor ishin forcat speciale norvegjeze dhe ato të Shërbimit Special Ajror Britanik (SAS), të cilat u përballën me trupat ruse që, një ditë më parë, kishin marrë nën kontroll Aeroportin e Prishtinës. Rusia synonte të dërgonte përf forcime shtesë nëpërmjet rrugëve ajrore, por pas ndërhyrjeve diplomatike të Shteteve të Bashkuara, Bullgaria, Hungaria dhe Rumania refuzuan kërkesën e Moskës për përdorimin e hapësirës së tyre ajrore.

Pas vështirësive të furnizimit të forcave ruse në aeroport, autoritetet ruse e cilësuan vendosjen e trupave të tyre si një veprim të gabuar. Zhvillimet e mëvonshme çuan në konsolidimin e pranisë së KFOR-it në Kosovë dhe në krijimin e kushteve për kthimin e mbi një milion shqiptarëve të dëbuar gjatë luftës, të cilët ishin strehuar si refugjatë në vende të ndryshme të rajonit, Evropës dhe më gjerë.

Dita Ndërkombëtare e Arkivave: Ruajtja e kujtesës dokumentare



Më 9 qershor shënohet Dita Ndërkombëtare e Arkivave, një datë e cila na kujton rolin jetik të arkivave në ruajtjen e trashëgimisë dokumentare dhe në mbrojtjen e kujtesës historike të shoqërive.

Kjo ditë u shpall nga International Council on Archives (ICA) me synimin për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e arkivave dhe rolin që ato luajnë në ruajtjen e trashëgimisë dokumentare. Ajo nënvizon domosdoshmërinë e mbrojtjes së dokumentacionit historik, promovimin e qasjes në të dhe nxitjen e shkëmbimit të njohurive dhe praktikave arkivore në nivel global.

Data 9 qershor u zgjodh për të përkujtuar themelimin e International Council on Archives në vitin 1948, nën kujdesin e UNESCO-s. Që prej asaj kohe, ICA ka qenë një forum ndërkombëtar, ku arkivistët dhe profesionistët e fushës ndajnë praktikatat më të mira, zhvillojnë standarde dhe nxisin bashkëpunimin global për ruajtjen e dokumentacionit.

Arkivat nuk janë thjesht depo të dokumenteve, por institucione të kujtesës që garantojnë vazhdimësinë e historisë, transparencën e institucioneve dhe të drejtën e qytetarëve për qasje në informacion.

Me nismën e International Council on Archives, kremtimi i Ditës Ndërkombëtare të Arkivave është zgjeruar në Javën Ndërkombëtare të Arkivave, gjatë së cilës profesionistët të arkivave nga rreth 200 vende promovojnë, përmes veprimtarive të ndryshme, punën e tyre dhe rëndësinë e arkivave në shoqëritë bashkëkohore.

Në mbarë botën, arkivistët dhe institucionet arkivore organizojnë ekspozita, konferenca, seminare, botime dhe fushata ndërgjegjëse në rrjetet sociale, duke vënë në pah rëndësinë e dokumenteve historike për studimet shkencore dhe kulturën kombëtare, rolin e arkivave në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe transparencën institucionale, si dhe nevojën për digjitalizim dhe qasje të hapur në dokumentacionin arkivor.

Përkujtojmë themelimin e Institutit të Sportit “Vojo Kushi” në Tiranë



Në vitin 1948 u ngrit institucioni i parë sportiv në Shqipëri, i cili u quajt Teknikumi i Fizkulturës, ndërkohë që ishte edhe e para shkollë e mesme për mësuesit e edukimit fizik. Në vitin 1958, pas krijimit të Universitetit të Tiranës, u hap dega e fizkulturës pranë Fakultetit Histori-Filologji.

Më 21 qershor të vitit 1960, me vendim të Këshillit të Ministrave u krijua Instituti i Fizkulturës, i cili një vit më vonë mori emrin “Vojo Kushi”.

Ngritja e këtij instituti përbën një moment themelor në historinë e arsimit dhe kulturës sportive shqiptare. Ky institucion u konceptua si qendër e formimit profesional dhe shkencor për gjeneratat e reja, duke u bërë një pol i rëndësishëm i zhvillimit të edukimit fizik dhe sportit në vend.

Instituti mbajti emrin e heroit të popullit Vojo Kushi, duke e lidhur misionin e tij arsimor me idealet e sakrificës dhe përkushtimit për atdheun. Përmes programeve të studimit, kërkimit shkencor dhe përgatitjes së specialistëve, ai kontribuoi në ngritjen e standardeve kombëtare të sportit dhe në afirmimin e tij si pjesë të identitetit kulturor shqiptar.

Drejtimin e institutit e mori fillimisht Kiço Karaguni (1958–1977), i cili vendosi bazat e formimit universitar në edukimin fizik. Pas tij, përgjegjësinë e mbajti Flutra Çelkupa (1977–1987), e cila konsolidoi strukturat akademike dhe zhvilloi programet e studimit. Në periudhat pasuese, drejtimin e morën figura të tjera si Sejfulla Shtëpani, duke vijuar procesin e modernizimit të kurrikulave dhe integrimin e kërkimit shkencor.

Në dekadat e mëvonshme, Instituti “Vojo Kushi” u shndërrua në një qendër referimi për edukimin fizik, duke nxitur jo vetëm zhvillimin e sportit elitari, por edhe përhapjen e kulturës së aktivitetit fizik në shoqëri.

Në vitet 2000–2010 u shndërrua në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve, e më pas në Universitetin e Sporteve të Tiranës. Roli i tij mbetet i lidhur ngushtë me proceset e modernizimit të arsimit dhe me përpjekjet për të integruar sportin si pjesë të formimit të gjithanshëm të individit.

Dita Botërore e Muzikës: Një festë globale e harmonisë dhe dialogut kulturor



Dita Botërore e Muzikës u themelua në Francë në vitin 1982 nga Ministri i Kulturës Jack Lang dhe kompozitori Maurice Fleuret, për t’iu krijuar hapësirë muzikantëve profesionistë dhe kryesisht atyre amatorë për të prezantuar punën e tyre në formën e një festivali muzikor.

Data 21 qershor u zgjodh që të përkojë me solsticin e verës, një ditë që simbolizon ekuilibrin e përsosur mes dritës dhe errësirës. Ajo shërben si një metaforë për harmoninë dhe unitetin që sjell muzika në jetën tonë, duke kapërcyer dallimet dhe duke nxitur një ndjenjë bashkimi.

Me moton “Faites de la musique” (Bëni muzikë), kjo festë u përhap shpejt në Europë dhe sot kremtohet në mbi 120 vende të botës, përfshirë edhe vendin tonë. Qëllimi i manifestimit ndërkombëtar të kësaj dite është që të inkurajojë muzikantët amatorë dhe profesionistë që të performojnë falas, duke e sjellë muzikën në hapësira publike për ta bërë atë të aksesueshme për të gjithë.

Në Tiranë dhe qytete të tjera, kjo ditë shënohet me koncerte të hapura, aktivitete të organizuara nga Bashkia dhe institucionet kulturore.

Nga Parisi deri në Nju Jork, nga Roma deri në Tokio, koncertet e Ditës Botërore të Muzikës përfshijnë çdo zhanër të muzikës: klasike, popullore, jazz, rock, muzikë alternative. Kjo ditë është një festë e kulturës së gjallë, ku muzika shndërrohet në mjet bashkimi dhe dialogu.

In memoriam

Akademia e Shkencave e Shqipërisë përkujton personalitete të shquara të shkencës dhe kulturës në muajin qershor

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në vijim të traditës së saj për të nderuar figurat që kanë kontribuar në zhvillimin e mendimit shkencor dhe kulturor shqiptar, përkujtoi gjatë muajit qershor personalitete, jeta dhe vepra e të cilëve mbeten pika referimi për historinë e dijes, kulturës dhe identitetit kombëtar.

Gjatë këtij muaji u përkujtuan, në përvjetorin e lindjes: Vaso Pasha, shkrimtar, politikan dhe patriot i shquar; Robert Elsie, albanolog dhe studiues i shquar i kulturës shqiptare; Idriz Ajeti, akademik dhe gjuhëtar i shquar; Rexhep Qosja, akademik dhe albanolog i shquar; Viktor Gjika, regjisor i shquar i kinematografisë shqiptare; Jani Vangjeli, akademik dhe botanist që i kushtoi jetën studimit të florës së Shqipërisë; Karlo Tagliavini, albanolog italian me kontribute në studimet e gjuhës shqipe dhe dialekteve të saj; Margaret Hasluck, albanologe skoceze me kontribute të rëndësishme në studimet shqiptare; si dhe Petraq Pilika, matematikan dhe akademik i shquar.

Po ashtu, u përkujtuan në përvjetorin e ndarjes nga jeta: Moikom Zeqo, shkrimtar, studiues dhe personalitet i shquar i kulturës shqiptare; Pierre Cabanes, albanolog francez me kontribute të rëndësishme në studimet e historisë së Ilirisë dhe botës shqiptare; dhe Petrit Gaçë, akademik dhe kirurg i shquar shqiptar.

Vepra e tyre shkencore, kulturore dhe krijuese përbën një trashëgimi të çmuar, e cila vijon të shërbejë si bazë referuese për studimet bashkëkohore dhe si burim frymëzimi për kërkimin shkencor dhe zhvillimin e mendimit akademik.

Përkujtimi i këtyre personaliteteve shpreh vlerësimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për kontributin e tyre në shkencë, albanologji, letërsi, arte dhe mjekësi. Vepra e tyre mbetet pjesë e trashëgimisë sonë shkencore e kulturore dhe vazhdon të frymëzojë studiuesit dhe brezat e rinj që ndërtojnë të ardhmen mbi themelet e dijes.

Ndahet nga jeta inxhinieri Ismail Ahmeti, një personalitet i shquar i historisë së energjetikës dhe ndërtimit shqiptar



Është ndarë nga jeta në moshën 84-vjeçare inxhinieri i shquar Ismail Ahmeti. Ai mbetet një nga figurat më të rëndësishme të zhvillimit hidroenergjetik në vend.

I lindur në Shkodër në vitin 1942, ai u diplomua në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit të Tiranës në vitin 1966. Që në fillimet e karrierës së tij u dallua për aftësi të jashtëzakonshme në menaxhimin e projekteve të mëdha hidroteknike, duke udhëhequr breza të tërë inxhinierësh.

Personalitet dhe drejtues i shquar në historinë e ndërtimit të digave dhe hidrocentraleve më të mëdha në vend, ai veçohet për drejtimin e punimeve në kaskadën e lumit Drin, një vepër unike jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Europë. Ai ka qenë kryeinxhinier i punimeve në Hidrocentralin e Fierzës, një nga arritjet më të mëdha të inxhinierisë shqiptare, ku luajti një rol kyç në menaxhimin e punimeve të mëdha të dheut, betonit dhe tuneleve të shkarkimit, duke e kthyer këtë kantier në një shkollë formimi për inxhinierinë shqiptare.

Më pas kontribuoi në ndërtimin e Hidrocentralit të Komanit, ku ka qenë drejtori i përgjithshëm i punimeve për të gjithë kompleksin e veprës. Ai ka drejtuar ndërtimin e digës dhe të të gjitha objekteve të HEC-it, përfshirë tunelet e shkarkimit me kapacitet total 3600 m³/s dhe veprën e marrjes së ujit për prodhimin e energjisë në këtë hidrocentral me kapacitet 600 MW.

Rezervuari i krijuar në Fierzë është ndër 10 rezervuarët më të mëdhenj në Europë edhe sot. Diga e Fierzës, me lartësi 167 m, mbetet më e larta në Shqipëri, ndërsa diga e Komanit, me lartësi 115 m, është e treta për nga lartësia në vend.

Gjatë një karriere 50-vjeçare, ai ka udhëhequr dhe mbikëqyrur edhe ndërtimin e rrugëve nacionale, akseve strategjike, urave me hapësira të mëdha, tuneleve hekurudhore dhe objekteve industriale që mbështetën zhvillimin ekonomik të vendit.

Për kontributin e tij të gjerë në zhvillimin energjetik dhe infrastrukturor të vendit, ai u vlerësua me titullin “Hero i Punës Socialiste”, ndërsa nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë mori certifikatën e mirënjohjes “Nderi i Akademisë”, duke u renditur mes personaliteteve më të shquara të elitës shkencore të vendit.

Ing. Ismail Ahmeti do të kujtohet si një drejtues vizionar dhe këmbëngulës, që la pas një trashëgimi të rëndësishme në historinë e ndërtimit dhe energjetikës shqiptare. Me ndarjen e tij nga jeta, Shqipëria humb një nga figurat e saj më të shquara, ndërsa veprat e tij mbeten dëshmi e punës, dijes dhe vizionit që kontribuan në zhvillimin e vendit.

Homazhet do të mbahen pranë agjencisë funerale Alba 2000, te ish-Ambasada Jugosllave. Ceremonia e përcjelljes për në varrezat e Sharrës do të zhvillohet të shtunën, më 20 qershor 2026, në orën 12:00.